



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 17 SHTATOR 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 17.
SEPTEMBAR 2009. GODINE

SHTATOR – SEPTEMBAR
2009

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Ibrahim GASHI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Mirë se keni ardhur në seancën e parë të sesionit vjeshtor! Shpresoj që deputetët kanë pushuar dhe kanë marrë energji për të vazhduar me punët e legjislacionit.

Konstatoj se në sallë janë 81 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar të gjitha kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotshme plenare.

E kemi vetëm një kërkesë për të dhënë një deklaratë apo një kërkesë nga deputeti Ismet Beqiri. E ka fjalën, kryetari i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticion, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: I nderuar Kryetar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Ju të cilët monitoroni punën e Kuvendit,
Të nderuar përfaqësues, gjegjësisht anëtarë të Qeverisë,
Zonja dhe zotërinj,

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione është i shqetësuar thellë, besoj edhe ju këtu në sallë dhe gjithë qytetarët e Kosovës dhe më gjerë për zvarritjen e cila po bëhet për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur tash e 10 vjet me radhë, duke lënë në ankth e pritje mijëra familje të cilat nuk dinë asgjë për më të dashurit e tyre. Edhe më shqetësues është fakti se tash e shumë vjet kanë mbetur të paidentifikuara mbetjet mortore të më se 405 trupave të cilët vazhdojnë të mbahen në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, gjë që ka detyruar një grup nënash të hyjnë në grevë shumëditore edhe në grevë urie në shenjë pakënaqësie me këtë gjendje.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione përkujton se Rezoluta e Parlamentit të Kosovës e datës 10 prill 2003 dhe Deklarata e 21 korrikut 2005, obligon institucionet për ndërmarrjen e të gjitha masave për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione edhe një herë shpreh nevojën për nxjerrjen e Ligjit për persona të pagjetur dhe kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës përshpejtimin e draftimit të ligjit në fjalë.

Komisioni ynë kërkon nga Komiteti Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur dhe nga Qeveria e Kosovës që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për identifikimin e mbetjeve mortore si dhe për ndriçimin e fatit edhe të rreth 2000 personave të zhdukur.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione kërkon nga të gjitha institucionet relevante ndërkombëtare të bëjnë presion tek Beogradi që të mos vazhdojë me mosbashkëpunim, bllokim të këtij procesi, sepse jemi të vetëdijshëm se qasja e gjertanishme nga shteti fqinj ka qenë jo koperuese dhe bllokuese.

Të nderuar deputetë,

Zbardhja e fatit të të pagjeturve dhe identifikimi i 405 mbetjeve mortore do të duhej të ishte temë e çdo bisede dhe takimi të zyrtarëve tanë të lartë shtetëror me zyrtarë të shteteve të ndryshme dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare.

Ndarja e mjeteve financiare për përshpejtimin e identifikimit të 405 mbetjeve mortore, përkrahja në të gjitha mënyrat e mundshme të Institutit të Mjekësisë Ligjore, gjetja e ndonjë mundësie alternative ku do të mund të bëhej identifikimi i mbetjeve mortore edhe një herë po e përsëris draftimi i Projektligjit për familjet e personave të pagjetur nga Qeveria, gjegjësisht Zyra e Kryeministrit dhe procedimi i tij sa më urgjent në Kuvendin e Kosovës për miratim, sepse definitivisht pushon çdo justifikim i mëtejshëm për mos draftim dhe mosmiratim të këtij ligji, sepse u bënë 10 vjet në liri dhe afër 10 vjet të krijimit të institucioneve tona shtetërore e ky ligj nuk është askund. Këto janë disa nga veprimet që duhet dhe do të mund të bëheshin.

Me këtë rast përshëndesim edhe angazhimin e krerëve të institucioneve tona shtetërore, veçmas Presidentit Sejdiu dhe ministres Kelmendi, por edhe të gjithë të tjerëve në ndërprerjen e grevës. Me gjithë shpirtin e thyer, të lodhura dhe me shëndet të keqësuar, nënat gjakovare, me veprimin e tyre do të duhej të ishin edhe një motiv shtesë moral e ligjor për një angazhim edhe më të fuqishëm për rezultate konkrete në zbulimin e të pagjeturve dhe identifikimin e mbetjeve mortore.

Dhe, fare në fund, zoti Kryetar,

Deputetë të nderuar,

Nëna të dashura gjakovare, nëna të tjera dhe familjarë të tjerë të të pagjeturve dhe të paidentifikuarve, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione do të organizojë një dëgjim publik ku do t'i ftojë të gjithë faktorët relevantë, vendorë dhe ata ndërkombëtarë prezent dhe kompetentë për këtë çështje, por veçmas do të kërkojë informatë ose raport nga Komisioni qeveritar për persona të pagjetur, me kërkesë të qartë, të dihet se çfarë është bërë gjer më tani dhe çfarë planifikohet të bëhet më tutje. Dhe, mbi bazën e kësaj informate, gjegjësisht raporti e në marrëveshje me Kryetarin e Kuvendit dhe Kryesinë, do të kërkojmë të caktohet edhe një seancë e veçantë plenare me të vetmen pikë të rendit të ditës- Personat e pagjetur dhe identifikimi i mbetjeve mortore ose së paku të jetë një pikë e rendit të ditës në ndonjërin prej seancave sa më parë që është e mundur. Zoti Kryetar, faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Mendoj tema që e ke ngritur është shqetësim për çdo qytetar të Kosovës dhe shpresojmë që Komisioni do ta shfrytëzojë edhe Komisioni qeveritar, por edhe grupet e ekspertëve për të pasur një raport më të detajuar dhe rekomandime për Kuvendin dhe Qeverinë çka do të bëhet mandej.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti Kryetar i Kuvendit,
Zoti Kryeministër dhe kolegë deputetë,

Unë kam dy fjalë për rendin e ditës. Ne kemi marrë një rend dite, por unë dua t'ju paraqes këtu mendimin dhe perceptimin e Grupit Parlamentar të LDK-së. Në një mbledhje që kemi pasur, si zakonisht para kësaj seance, kërkohet që në Kuvend kur të vijnë ligjet për Presidentin dhe për Qeverinë, të vijë edhe Ligji për përgjegjësitë dhe detyrat e deputetit. Nënshkruesit e një kërkesë që ky ligj të shpejtohet dhe të vijë në Kuvend, janë edhe të LDK-së. Ju e dini që janë mbi 80 nënshkrues të Kuvendit që e aktualizojnë. Unë ashiqare po dëgjoj edhe reagime të deputetëve të partive të tjera. Unë këtu kam dal të paraqes kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së. Pra, është koha që ligjet e tilla sistimore që nxirren për Presidentin dhe për Qeverinë, që janë të domosdoshme, të nisin apo të shoqërohen me Ligjin për deputetët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Mendoj që kërkesa e anëtarit të Kryesisë është dashur të bëhet në Kryesi dhe mendoj që është e vonuar. Nën dy, ju e dini se ne kemi kërkuar nga Ministria për Ekonomi dhe Financa që ta sjell koston e ligjit dhe mbi bazën e kësaj ne ta marrim një vendim. Mendoj që kjo çështje duhet të jetë dhe ne presim përgjigje nga Ministria për Ekonomi dhe Financa, pastaj ligji të hyjë në procedurat e Kuvendit.

Emrush Xhemajli, e ka kërkuar fjalën.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

E nderuara Kryesi,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I bashkëngjitëm asaj që i thanë dy parafolësit e mi. Unë kam kërkuar fjalën për rendin e punës. Pikat 3, 4 dhe 5 mendoj se duhet të jenë për herën tjetër, ndërkaq pika lidhur me debatin për lirinë e medias duhet të jetë si pikë e veçantë në një seancë të veçantë dhe ky ishte arsyeimi për shkak të mos përzierjes së temave, kjo është më mirë sa i përket pikës 11.

Sa i përket pikës për Projektligjin dhe për Qeverinë, Projektligjin për shërbyesit civilë dhe pagat e nëpunësve civilë, unë sapo u konsultova edhe me kryetarin e Komisionit për Administratë, Pushtet Lokal.

Në Komisionin për Administratë, Pushtet Lokal këto tri ligje janë shqyrtuar, ka pasur shumë vërejtje ku janë konstatuar shumë të meta. Te Ligji për shërbyesit civilë është fare pa përcaktuar më së pari çka quajmë nëpunës civil, cilat kategori të nëpunësve i përfshinë e kështu me radhë. Domethënë, ka pasur të meta shumë të mëdha lidhur me këtë.

Edhe sa i përket Ligjit të Qeverisë, me qenë se janë të konstatuar këto të meta edhe nga vetë propozuesit e ligjit, këto ligje ju e dini janë tërhequr, mirëpo janë tërhequr që të vijë një draft i përmirësuar. Unë si deputet, por edhe Komisioni nuk ka marrë një draft të përmirësuar nga ata që janë zotuar se do t'i përmirësojnë edhe do t'i dërgojnë. Unë, së paku s'e kam marrë, ndoshta ju të tjerët e keni marrë, kështu që me qenë se drafti ende s'ka ardhur lidhur me këtë, ju kisha lutur që këto të shtyhen, përndryshe kanë aso të meta për të cilat është shumë vështirë të kalojnë këto ligje ashtu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Adem Salihaj e ka kërkuar fjalën. Veç po ju njoftoj që me Rregullore të Punës së Kuvendit vërtet s'keni pasur të drejtë ta merrni fjalën, megjithatë po u jap fjalën pasi jemi në Asamblenë Komunale të Prishtinës.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Mendoj se kemi të drejtë ta marrim fjalën për rendin e ditës dhe po e shfrytëzojmë këtë. Pajtohem në tërësi me dy parafolësit e mi. Flas në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së. Edhe Grupi Parlamentar i LDD-së kërkon që të tërhiqen të tri ligjet të cilat një herë janë tërhequr pa asnjë sqarim dhe janë sjell tash përsëri pa asnjë shpjegim pse janë ri sjell. Dhe, ka qenë qëndrim i Kuvendit të Kosovës në një seancë të kaluar që këto projektligje të vijnë bashkë me Projektligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit. Ne e dimë që po bëhet thjesht një lojë me këtë projektligj, gjëja se po pritet deklarata financiare që s'është e saktë, zoti Kryetar, ne e dimë të gjithë këtë. Dhe, nuk keni pasur të drejtë të mos e futni në procedurë në Kuvend kur janë bërë 86 nënshkrime të deputetëve të Kuvendi dhe një çështje tjetër që duhet sqaruar rreth aspekteve financiare. Ky projektligj prek buxhetin e Kuvendit të Kosovës dhe koston financiare mendoj se duhet ta bëjë dhe do ta bëjë Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe ai mund ta bëjë për një periudhë shumë të shkurtër. Deklaratën për implikime financiare e ka ky projektligj që në vitin 2007 dhe nuk është bërë asnjë rritje me amendamentet që kemi bërë, përkundrazi kostoja është më e vogël se sa atëherë kur është proceduar në Kuvend dhe të gjitha tjerat janë vetëm lojëra për të mos e sjell këtë projektligj në Kuvend.

Ne nuk do të votojmë për këtë rend dite, nëse nuk tërhiqen këto tri pika dhe nëse nuk hyn edhe projektligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni, deputeti Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndoshta duhet të pajtohem që Projektligji për deputetët duhet të sillet në Kuvend, sepse nuk e dimë edhe shumë pse po qëndron shumë gjatë për një deklaratë financiare, mirëpo nuk pajtohem me konstatimet, qoftë të zotit Emrush që të bisedojë në emër të Komisionit, me siguri, për Shërbime Publike se projektligjet të cilat janë sjellë kanë shumë gabime dhe nuk janë të hartuara mirë. Së pari, konstatoj sepse Komisioni fare nuk ka diskutuar për këto projektligje dhe nuk ka pasur mundësi të konstatojë dhe çështja tjetër nuk e di se sa kanë qenë në gjendje t'i shohin dhe t'i shqyrtojnë këto projektligje. Realisht, projektligjet që kanë ardhur nga Qeveria e Kosovës janë projektligje organike, shumë të rëndësishme dhe nuk kanë gabime siç po pretendohet. Është shumë e vërtetë se ka ardhur një letër nga Zyra e Kuvendit të Kosovës për disa konstatime, por ato konstatime kanë qenë më tepër politike, që nuk është e drejtë e zyrtarëve të Kuvendit të japin konstatime për çështje politike. Ligjet janë të hartuara shumë mirë dhe krejt çështja mund të qëndrojë a duhet të vijë Ligji për Qeverinë, është çështje tjetër në aspektin politik, por nëse flasim në aspektin ligjor, ligjet janë të hartuara, bile mund me plot përgjegjësi të themi janë ndër ligjet e hartuara mirë që kanë ardhur deri më tani. Prandaj, është mirë të lexohen këto ligje dhe të mos dilet këtu para deputetëve me konstatime të paqarta. Është mirë, ne të debatojmë për projektligjet dhe t'i shohim ku janë ato gabime. Sidomos Ligji për shërbimin civil, domethënë, në mënyrë të qartë i bën dallimet edhe ndërmjet nëpunësve civilë të karrierës edhe për ata të jo karrierës, Ligji për Qeverinë është i kompletuar dhe ndoshta çështja mund të jetë vetëm për çështjen a duhet, a ka buxhet për t'u aprovuar këto ligje, por ne e kemi edhe një letër të Kryeministrit që ka ardhur në Kuvend të Kosovës dhe natyrisht janë hequr ato dilemat rreth vërejtjeve që

kanë qenë nga faktori ndërkombëtar sa i përket buxhetit? Prandaj, kërkoj që këto ligje të mos tërhiqen, sepse janë ligje organike. Ka qenë një mund i madh t'i sjellim këto ligje, kam qenë edhe unë- një kohë jam angazhuar në hartimin e këtyre projektligjeve dhe mos të jetë vetëm çështje politike sa për të dal për të konstatuar se këto ligje nuk janë të hartuar mirë.

Prandaj, ne si Komision i mbështesim, sepse edhe unë, nga vetë fakti, se kam pasur rastin të punoj për këto ligje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ndërpresim debatin. Është votimi, ai që do ta përcaktojë. Nuk bën asnjë shpjegim. Vota le ta verifikojë atë që u tha.

(Ndërhyrje)

Nuk kemi nevojë për të shpjeguar absolutisht. E kemi kërkesën për t'i hequr 3 ligje, pikën 3, pikën 4 dhe pikën 5. Ju lutem, kërkesën e anëtarit të Kryesisë. Nuk ka fjalë, ka vetëm votim. Kërkesa e anëtarit të Kryesisë, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, po them për mua është e pakuptimtë për faktin se në mbledhjen kur është hartuar, pra është bërë rendi i ditës ka qenë anëtari i Kryesisë, ka qenë shefi i Grupit Parlamentar. Megjithatë, po e bëjmë kërkesën, pra që edhe ai ligj ta ketë fatin e 3 ligjeve që u kërkuar të tërhiqen dhe vendimin e marrim më vonë për fatin e këtyre ligjeve dhe të ligjeve për deputetët.

Kush është për t'i hequr tri pikat – tri ligjet nga rendi i ditës, pikën 3, 4 dhe 5?

(Ndërhyrje)

Po them, të hiqen nga rendi i ditës së sotëm. Është kërkesa. Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti Kryetar i Kuvendit, Jakup Krasniqi.

Unë e di që ti rregullat i di shumë mirë, sikur unë, që çdo rend dite propozohet nga Kryesia, por nuk është rend dite deri sa të mos votohet në Parlament. Nën një.

Nën dy, si anëtar Kryesie asgjë nuk më pengon që ta artikuloj mendimin e Grupit Parlamentar të LDK-së, grupin e dytë më të madh të Kuvendit të Kosovës, i cili e shtron një çështje për rend dite në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Unë s'kam bërë asgjë, as më shumë as më pak dhe këtë besoj e kam paraqitur ashtu si duhet. Nëse Kuvendi mendon që kjo që po propozoj unë nuk vlen, mos ta votojë. Dhe, këtu mbaron diskutimi, nuk kemi nevojë të bindemi. Unë nuk kam kërkuar të hiqet kurrë prej rendit të ditës. Unë kam kërkuar në emër të LDK-së që bashkë me to të qitet në rend dite edhe Ligji për deputetët. Kjo është kërkesa ime, nuk ka kurrfarë derivimi tjetër. Faleminderit! Qite në votim!

KRYETARI: Ligji që po kërkohet të hyjë, nuk është në material me këto ligje dhe ne mund t'i heqim 3 ligje që të vijë edhe ai në një mbledhje tjetër të rendit të ditës, por për sot nuk hyjnë në rend dite. Urdhëro, zoti Kryeministër.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar Kryetar!
Të nderuar të gjithë deputetë,

Ministra, zëvendëskryeministra,

Duke uruar fillimin e sezonit vjeshtor të jetës parlamentare në Kosovë, në emër të Qeverisë së Kosovës për të gjithë ju, dëshiroj të theksoj se natyrisht tash ka qenë një periudhë e pushimeve dhe mbushje e energjive për prezantime më energjike në kuptimin e pikëpamjeve dhe të angazhimeve politike. Besoj se në këtë drejtim të gjithë janë të përkushtuar që t'i gjejmë zgjidhjet më të mira të mundshme edhe sa i përket kësaj çështjeje që u ngrit këtu.

E para, sa u përket projektligjeve të cilat janë prezantuar, të gjitha këto projektligje kanë kaluar për rend dite përmes Kryesisë dhe aprovuar, natyrisht Kuvendi merr vendimet këtu, në fund. Por, dëshiroj të theksoj se në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës këto projektligje nga ajo që shihet pasi që ka qenë një periudhë goxha e gjatë e pushimit, kërkohet një konsultim pak sa më i thellë, më i gjerë dhe vlerësim i këshillave. Besoj edhe zoti Hamiti do të reflektojë në kuptimin e angazhimit pozitiv për çështjen që e ngriti, prandaj do të propozoja në emër të Qeverisë që këto projektligje të shtyhen në njërën nga seancat e ardhshme duke mos e hedhur në votim fare se nuk ka nevojë se të gjithë jemi edhe deputetë edhe përgjegjësi tjera kemi. Mirëpo, këtu u dëgjua edhe propozimi tjetër gjithashtu që ndoshta ia vlen për të diskutuar, propozimi për t'i ulur pagat për deputetë dhe ministres, mua mu duk shumë interesantë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Edhe Qeveria u pajtua që të hiqen nga rendi i ditës pikat 3, 4 dhe 5 dhe kur të kthehen këto ligje, kthehet edhe Ligji për deputetët. Kush është “për”? Sekretaria i numëroni votat. Kush është “kundër”? 4 vota “kundër”. A ka abstenime? Një abstenim. Rendi i ditës u krye.

Konstatohet se me 84 vota “për”, 4 “kundër” dhe një abstenim, shtyhen tri pikat e rendit të ditës dhe kërkesa e Sabri Hamitit. Jo, rendi i ditës u krye, nuk votohet kurrë rendi i ditës.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

(Ndërhyrje)

Nuk votohet në asnjë seancë rendi i ditës, po miratohet në Kryesi, me shefat e grupeve parlamentare. Nuk shkruan kurrkund të miratohet.

- Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 17, 23 dhe 24 korrik

Fjalën e ka deputeti Fehmi Rexhepi.

(Ndërhyrje- Është fjala për Fatmir Rexhepin.)

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përkundër këtij starti, unë megjithatë jam Fatmir Rexhepi e jo Fehmi Rexhepi. Lidhur me procesverbalin nga transkripti i datës 23 dhe 24 korrik, unë kam dy përmirësime të nevojshme. I pari, në faqen 24, ku nuk duhet të jetë pra 46 milionë euro në atë pjesë ku thuhet në transkript, po duhet të jetë 46 mijë euro, sepse është dallim shumë i madh. Ku është ai fat të jenë 46 milionë për rrugën e Stançiqit, është gabim. Dhe, në faqen 25, po ashtu, një përmirësim të fjalës, në pjesën e parafundit të kapitullit, ku kemi të bëjmë me bartjen dhe ndarjen e mjeteve prej 10 milionë- shumë për vitin 2010, në ndërtimin e

pjesës lindore të autostradës, pra kjo duhet të jetë aty se ashtu ka qenë- Prishtinë – Gjilan – Bujanoc. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Administrata, sigurisht që e bën këtë përmirësim të transkriptit. Megjithatë, po ua jap fjalën, por ju lutem ju e dini si bëhet kërkesa për të shtuar apo tërhequr një çështje të rendit të ditës. Mund të konsultoheni siç është konsultuar Ismet Beqiri, pastaj edhe ju mund ta kryeni këtë punë në mënyrën më të rregullt të mundshëm, sipas Rregullores gjithnjë.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Faleminderit, Kryetar!

Ashtu siç vepruan edhe të tjerët, do të thotë, po veprojmë edhe ne, prandaj mos të aplikojmë standarde të dyfishta, ju lutem!

Duke marrë parasysh rëndësinë e debatit për lirinë e medias, si inicuese e këtij debati dhe në emër të deputetëve nënshkrues, kërkojmë që të tërhiqet sot nga pika e rendit të ditës, në mënyrë që të debatohet si pikë e veçantë në seancën e radhës. Faleminderit!

KRYETARI: Janë dy kërkesa për t'u hequr nga rendi i ditës pika 11- Debati për lirinë e medieve, Edhe pse është miratuar rendi i ditës, megjithatë po e rikthejmë këtë kërkesë që mos të mbetet një çështje. Hiqet nga rendi i ditës ose shtyhet pika 11 e rendit të ditës. Kush është “për”, ju lutem? Kush është “kundër”?

Konstatohet se me 50 vota “për”, 14 vota “kundër” dhe një abstenim, hiqet nga rendi i ditës pika 11 me kërkesën e Grupit Parlamentar të AAK-së dhe të deputetit Emrush Xhemajli.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës-

- Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetjen e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Vazhdojmë në procedimin e pyetjeve.

Pyetja e parë është e deputetit Riza Smaka, pyetje për ministrin e Tregtisë dhe të Industrisë, zotin Lutfi Zharku.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti Kryetar,

Deputetë të respektuar,

Çështja, sipas të dhënave zyrtare nga ekspertët e vendit tonë hekurishtet ... e kapin shkallën 40% sa i përket eksporteve, ju lutem. Ndryshe, çmimi i hekurishteve në fjalë me bazë mund të presumohet të jetë jashtëzakonisht i ulët.

Zoti ministër, Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, të cilën ju aktualisht e administroni, a ka ndonjë pikëpamje programore për krijimin e kushteve sadopak të përshtatshme për përpunimin e këtyre hekurishteve që njëkohësisht edhe do të ishte me influencë edhe për punësimin edhe për çmimet më njerëzore t'i quaj këssoj kushtimisht. Faleminderit!

KRYETARI: I nderuar ministër e ke fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra, kolegë deputetë,

I nderuar deputet Smaka,

Departamenti i Industrisë i cili funksionon në kuadër të MTI-së në vitin 2005 ka hartuar një studim në lidhje me mundësinë e shkrirjes dhe përpunimin të mbetjeve metalike, duke marrë parasysh se mbeturinat metalike përbëjnë pjesën më të madhe të eksporteve tona e që konsiderohet bazë e mirë për përpunim edhe në vendin tonë.

Konkluzionet e nxjerra nga ky studim rekomandojmë programe të ndryshme për përpunimin e mbeturinave metalike përmes ndërtimit të mini-shkritoreve, por të cilat mund të jenë produktive vetëm nëse shkrirja e mbetjeve metalike përpunohet në produkt final. Natyrisht ndërtimi i tyre presupozon mjete të konsiderueshme financiare e që bizneset tona, shumica absolute e të cilave janë mikro dhe të vogla, nuk mund ta sigurojnë.

Në kontekst të këtij Agjencioni për Promovimin e Investimeve është interesuar të tërheqë investitorë të huaj edhe në këtë fushë. Deri më tani janë zhvilluar biseda serioze me dy kompani, njëra nga Arabia Saudite dhe tjetra nga Turqia, por pa ndonjë rezultat konkret, përkundër asistimit tonë të madh gjatë vizitave të tyre në disa komuna dhe biznese të ndryshme.

Më lejoni t'ju informoj se MTI është në fazën në hartimin e strategjisë për zhvillimin e industrisë 2009 – 2013, e cila parashihet të përfundohet gjatë këtij viti. Ne besojmë se në këtë strategji do të parashihen edhe programe të ndryshme për përpunimin e mbeturinave metalike. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë? Faleminderit!

Vazhdojmë. Deputeti Arsim Rexhepi, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala. Arsim Rexhepi, a është këtu? Mirë, faleminderit që e ke tërhequr e që po e tërheq tash.

Deputetja Rita Hajzeraj, pyetje për Kryeministrin zotin Hashim Thaçi, deputete e ke fjalën.

RITA HAJZERAJ : Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar Kryeministër,

Mungesa e elasticitetit fiskal edhe më tutje është barrë e rëndë për iniciativat e biznesit kosovar. Mbetet taksa doganore prej 10% që destimulon dhe pamundëson të gjitha ata njerëz që kanë ndërmend të nisin ndonjë iniciativë të prodhimit në Kosovë. Me këtë taksë e cila është uniforme bëhet gati e pamundshme që biznesmenët kosovarë të konkurrojnë në tregun tonë ndaj prodhimeve të rajonit, e posaçërisht atyre serbe të cilat edhe më tutje nuk e paguajnë 10% të taksës doganore si problem i Rezolutës 1244 apo i mosrespektimit të Marrëveshjes së CEFTA- s.

KRYETARI: Faleminderit!

Mendoj që kërkesa e anëtarit të Kryesisë është dashur të bëhet në Kryesi dhe mendoj që është e vonuar. Nën dy, ju e dini se ne kemi kërkuar nga Ministria për Ekonomi dhe Financa që ta sjell koston e ligjit dhe mbi bazën e kësaj ne ta marrim një vendim, mendoj

që kjo çështje duhet të jetë edhe ne presim përgjigje nga Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe pastaj ligji të hyjë në procedurat e Kuvendit.
Emrush Xhemajli, e ka kërkuar fjalën.

EMRUSH XHEMAJLI: Pyetja ime është – Cilat hapa janë ndërmarrë nga Qeveria për inkurajimin e prodhimit në Kosovë? Me theks të veçantë më intereson të di se a do të ketë lëvizje në taksën doganore prej 10%, kryesisht kur bëhet fjalë për import të pajisjeve që janë të dedikuara për prodhim.

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar Kryetar!

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra dhe të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë që përpiqem të përgjigjem në disa nga pyetjet e deputetëve.

E nderuara deputete,

Pyetja konsideroj se i është drejtuar më tepër Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, prandaj në marrëveshje me Kryeministrin e mora përgjigjen. Sigurisht që politikat doganore janë një nga instrumentet që secili shtet i ka në dispozicion për t'i përcaktuar barrierat e veta dhe mbrojtjen e produkteve, eventualisht vendore ose prodhuesve vendor.

Politika e Qeverisë së Republikës së Kosovës karshi regjionit dhe trendëve në përgjithësi regjionale ka qenë që të kemi një taksë të sheshtë, të doganave 10% me qëllim që të mbushet buxheti dhe në anën tjetër të kemi mundësi që t'i mbrojmë disa nga prodhuesit vendor.

Përpjekjet e Qeverisë së Kosovës dhe mendoj rezultatet e saja janë duke u transformuar që doganat e Kosovës gjithnjë të kenë një rol sa më të ulët në mbushjen e arkës së shtetit, por rol sa më të lartë në mbrojtjen e qytetarëve të Kosovës, qoftë nga siguria, përkatësisht importi i produkteve të rrezikshme, qoftë nga mënyra të tjera stimuluese për të lehtësuar importin e produkteve dhe sidomos në sferën e prodhimit.

Doganat e Kosovës, përkatësisht Ministria e Ekonomisë dhe e Financave që nga momenti i transferimit të kompetencave të doganave nga nëntori i vitit të kaluar, janë duke gjetur forma që pajisjet për prodhim dhe ato që krijojnë vendeve të punës të lehtësohen dhe të paguhen, qoftë në formë të kësteve në qoftë se i afrohet garanci bankare, qoftë të depozitohen në depo doganore në mbikëqyrjen doganore, në mënyrë që të lehtësohet barra e momentit gjatë importit.

Sigurisht që në vitet e ardhshme doganat do të kenë një rol gjithnjë më të ulët në mbushjen e arkës, ne prezantojmë të jemi në Unionin Evropian dhe sigurisht që pas 5 deri 7 vjetëve doganat do të jenë zero, po thuaj se taksa doganore për të gjitha importet e sidomos për prodhimet, andaj kompensimi i kësaj fushe financiare do të bëhet përmes formave të tjera të vjeljes së taksave indirekt apo direkt. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr anëtari i Kryesisë, Ibrahim Gashi.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Deputete, a ke pyetje shtesë? Jo. Faleminderit!

Kalojmë në pyetjen e radhës. Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin Ahmet Shala. Urdhëro, zoti deputet.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër, ka kohë që në PTK punësohen numër i madh i punëtorëve pa konkurs. Sipas një interviste të drejtorit të PTK-së, ai thotë se bordi ka vendosur që të punësohen 382 punëtorë të rinj edhe ata janë pranuar në bazë të kontratës mbi vepër, pra pa konkurs. Ju lutem, na shpjegoni se cili ligj e parasheh këtë kontratën mbi vepër dhe na shpjegoni se çka është kontrata mbi vepër për shkak se në legjislacionin e Republikës së Kosovës unë nuk e kam hasur? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër,

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit! I nderuar deputet,

Unë pas marrjes së pyetjes kam kërkuar nga Bordi i PTK-së që të më jap përgjigje në lidhje me pyetjen tuaj dhe pas konsultimeve po ashtu edhe me Departamentin tim juridik dhe Departamentin e monitorimit të ndërmarrjeve publike kam marrë përafërsisht shpjegimin se të gjitha punësimet që janë bërë në Postë-Telekomin e Kosovës janë bërë në bazë të planeve investuese dhe zhvillimore që i ka aprovuar Bordi i Postë- Telekomit të Kosovës dhe një nga mbledhjet e Bordit më 8 prill të vitit 2009, siç thuhet në këtë shpjegim për mua, Bordi i Postës ka aprovuar një plan më intensiv të investimeve dhe në bazë të këtij plani i është dashur edhe numër më i madh i punëtorëve. Aspekti i rregullimit të kontratës së punës më është rekomanduar se është bërë në bazë të Ligjit të punës dhe në bazë të gjitha procedurave që janë në fuqi.

Unë e kam angazhuar njësinë time për auditim dhe kam kërkuar po ashtu edhe nga auditori i brendshëm i Postës që të më jap shpjegime plotësuese. Në momentin kur i marrë të gjitha shpjegimet mbi këtë veprim, sigurisht që do të vij dhe të përgjigjem edhe për juve edhe për deputetë tjerë.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputet, a ke pyetje shtesë?

DRITON TALI: Unë po habitem si s'po e di zoti ministër që s'kemi Ligj të punës. Nuk është e vërtetë që kontrata mbi vepër është juridikisht e rregulluar, kjo është formë se si punësohen partizanët politikë dhe nuk është numri 384 i të punësuarve, është mbi 600, ndonëse nuk kam asgjë kundër atyre të cilët janë punësuar se kanë nevojë për punë, janë hallexhinj, ama rregullojeni me ligj, sepse nuk e keni në ligj. Po kjo është edhe një vërejtje e EULEX-it. Më mirë le të merret me këto punë, se sa të na shkruaj protokolle me Serbinë, le t'i kryej punët për çka paguhet dhe për çka është thirrur në Kosovë. Kjo është shkelje e ligjit dhe dikush duhet të merret...nuk është vetëm se PTK-ja, por ke edhe në të gjitha ndërmarrjet tjera publike ku punësohen partizanët politikë në bazë të njëfarë termi që e keni farkuar tashti, jo veç kjo Qeveri, por edhe e kaluara. Kontratë mbi vepër nuk ka. Është mënyrë jo ligjore e të punësuarit të nipave, partizanëve politikë e familjarëve e tjera, mandej edhe e biznes partnerëve nganjëherë.

KRYESUESI: Faleminderit! Ministër ke, përgjigje.

MINISTRI AHMET SHALA: Zoti kryesues,

Unë e dhashë përgjigjen më duket ndoshta për sqarim edhe një herë. Përgjigja ime ishte. Kam angazhuar juristët e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe kam kërkuar edhe

nga Komiteti i Auditimit që është secila ndërmarrje publike që të më sjell konform ligjit se çfarë dhe cilat kanë qenë ato rregulla në bazë të cilave janë punësuar dhe në momentin kur ta marrë këtë përgjigje më të saktë, sepse pyetjen e mora para pakë ditësh, do t'i japë për juve edhe për të tjerët sqarimet e sakta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Vazhdojmë me pyetjen e radhës. Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin Ahmet Shala.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti kryesues,

Deputetë të nderuar, ministra të respektuar,

Në vendin tonë normat interesore bankare gjithnjë janë tepër të larta dhe për aq janë destimulative për kreditime në biznese produktive. Gjithsesi në masë të konsideruar normat interesore bankare në parim formohen konform me premiset e ekonomisë së tregut jus dispozitivum, megjithatë jo vetëm në vendin tonë, por edhe në shtetet me ekonomi të tregut të përparuar dhe të konsoliduar shtetin në masë të konsideruar madje jo rrallë herë interferon jus inperativum, veçanërisht kundër trajtave të ndryshme të marrëveshjeve monopoliste e këtë e bëjë shoqëritë aksionare me përgjegjësi të kufizuara që janë ... dhe të konkurrencave jo të ndershme në ekonominë kosovare.

Zotëri Shala,

A gjykoni dhe, nëse po, si e konsideroni që të influenconi efektivisht në reduktimin e dukshëm të normave interesore jashtëzakonisht të larta edhe destimulative për bizneset kosovare? Ju falënderohem!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Zoti ministër.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar profesor Smaka,

Sinqerisht duke qenë në Parlament që një vit e më tepër kam filluar të mësoj mjaft terme edhe latine siç është jus dispozitivum edhe pse për mua ka qenë vështirë për ta kuptuar, por gjithsesi kam shfletuar dhe shumë terme tjera latine për të cilat vërtet të admiroj, por shpeshherë për mua kanë qenë vështirë për t'i kuptuar. Gjithsesi pyetja është vërtet një shqetësim për të gjithë ne. Qeveria e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës po përpiqet që në mënyrë indirekte të ndikojë në uljen e normave të interesit. Fatmirësisht normat e interesit në depozite kanë shënuar një rritje, por normat e interesit në dhënie në fakt po ashtu vitin e kaluar kanë qenë mjaft të larta, por nuk janë më të larta shumë se sa në regjion. Një element që është veçues për Republikën e Kosovës është se Banka Qendrore e Kosovës duke pasur parasysh se kemi në qarkullim euron nuk ka mundësi të zhvillojë politikë monetare dhe në bazë të kësaj vështirë e ka që t'i përcaktojë edhe normat e interesit të bankave.

Qeveria e Republikës së Kosovës është duke përmbyllur Ligjin për huat publike i cili do të sillet në Parlament besoj Qeveria do ta aprovojë mbase edhe në javën e ardhshme, i cili do jep mundësi që Banka Qendrore e Kosovës të ketë mundësi të emitojë instrumente të ndryshme të pagesës të cilat në qoftë se jemi të suksesshëm t'i zbatojmë në mënyrë ashtu siç janë paraparë me ligj, besoj që do të mundësojmë një ulje të normave të interesit, një kthim të parave të cilat janë të investuara në botën e jashtme dhe në këtë mënyrë indirekte pra, duke mos pasur valutën tonë do të përpiqemi që të ndikojmë në normat e interesit.

Pastaj, diku në fund të tetorit ne do të fillojmë inicimin e kreditrajtng që thonë, kemi pritur që ligji të sillet në Parlament dhe besojmë që me një kreditrajtng mbase që do të jetë goxha e rëndësishme që të gjithë së bashku të punojmë, Kosova do të ketë një pasqyrë të saktë për shkallën e rrezikut të institucionet e rëndësishme, qofshin bankare, qofshin investuese dhe do të përcaktohet saktë shkalla e rrezikut e cila mund të jetë shpeshherë më i lartë se sa vetë përcëpcioni që është për shkallën e rrezikut të investimeve, si dhe elemente tjera të funksionimit të shtetit, sidomos të gjykatave për të cilat, përcëpcioni është se ka një shkallë të rrezikut të mos ekzekutimit të vendimeve gjyqësore ose të procedimit të lëndëve në gjyq e të cilat e risinë shkallën e rrezikut në Kosovë.

Janë këto disa nga përpjekjet tona që edhe pse nuk kemi valutën tonë, pra për të intervenuar në treg dhe për t'i ulur kamatat ne përmes këtyre instrumenteve besoj që vitet e ardhshme do të kemi një treg më konkurrues. Licencimi i bankave është po ashtu një element tjetër për të mundësuar që konkurrenca të jetë sa më lartë dhe në këtë mënyrë vetë konkurrenca të shtyjë bankat të ulin kamatat. Janë këto të vetmet mundësi të cilat mund të jenë në dispozicion të një Qeverie, të një shteti që përdor një valutë të huaj në tregun e vetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

A keni pyetje shtesë, zoti deputet? Jo. Faleminderit!

Vazhdojmë me pyetjen e radhës. Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashin. Deputete, e keni fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Së pari, mendoj se duhet t'i informoni deputetë se unë i pata tri pyetje, një pyetje ishte për zotin Kryeministër, i cili në vazhdimësi është mospërfillës dhe injorues ndaj Kuvendit, me këtë vërtetë ... popullit, se këta deputetë janë përfaqësues. Por, gjithashtu, e dyta ka qenë për ministrin Pajaziti.

KRYESUESI: Tash vjen edhe pyetja që po flisni, do me thanë pas saj.

GJYLNAZE SYLA: Zoti ministër, pyetja ime ka të bëjë me një çështje shumë të rëndësishme për sistemin shëndetësor dhe këto janë sigurimet shëndetësore.

Sipas Strategjisë legislative edhe atë të mëparshme, por edhe të kësaj të fundit që është sjell për ndryshimin dhe plotësimin nga ana e Qeverisë të agjendës legislative, është paraparë që ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për sigurimet shëndetësore të kalojë në Kuvendin e Kosovës në qershor të këtij viti, megjithatë ne nuk e kemi pasur në shqyrtim në Kuvend. Prandaj, pyetja ime është: -Kur do të procedohet për shqyrtim në Kuvend ky projektligj, do të thotë Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për sigurimet shëndetësore? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete!

Zoti ministër.

MINISTRI ALUSH GASHI: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

E nderuara zonja deputete Gjylnaze Syla,

Ju falënderoj për përkujdesën që kjo pyetje do të jetë në Kuvendin e Kosovës. Është një prej çështjeve më të rëndësishme për sistemin shëndetësor të Republikës së Kosovës dhe është pika e përkushtimit prioritar të Ministrisë së Shëndetësisë.

Ne, ashtu siç thatë ju kemi punuar me shumë përkushtim në ri hartimin e Ligjit për sigurime shëndetësore. Ministria e Shëndetësisë e ka kryer Projektligjin së bashku me ekspertë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave ka përgatitur një kosto buxhetore dhe ligji është në procedurë për të ardhur në Parlament. Unë shpresoj që pas debatit në Kuvendin e Kosovës dhe në organet e saj funksionale, ne do ta kemi ligjin me kohë që të mund të fillojë së zbatuari në momentin që e parasheh Kuvendi i Republikës sonë. Do të thotë, Projektligjin e kemi përfunduar, kemi përgatitur koston buxhetore dhe është në procedurë të ardhjes në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!
Deputete, a keni pyetje shtesë? Si duket po.

GJYLNAZE SYLA: Zoti ministër, unë nuk e mora përgjigjen e saktë kur do të vijë në Kuvendin e Kosovës, do të thotë, datën. Sa i përket zbatimit të tij, me qenë se tani po u ditka kostoja, pyetja ime shtesë është: - Sa është kostoja e këtij ligji dhe a është siguruar buxheti duke marrë parasysh se as në buxhetin e këtij viti, por as në Kornizën afatmesme të shpenzimeve nuk është paraparë shuma për zbatimin e këtij ligji? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër,

MINISTRI ALUSH GASHI: Zonja deputete,
Ne, ashtu siç kemi garantuar në Qeveri dhe siç është miratuar në Kuvendin e Kosovës, ne në kuadër të asaj kornize legjislative ligjin e kemi përgatitur, e kemi përgatitur një kosto buxhetore të përballueshme. E kemi paraparë në Kornizën afatmesme të shpenzimeve me paketën e ligjeve që vjen në Qeveri, por vendimin definitiv dhe të vetmin se kur do të fillojë zbatimi i këtij ligji do ta japë natyrisht Kuvendi i Kosovës dhe do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga Presidenti.

Nëse juve ju intereson shkallëzimi i ngritjes së koston buxhetore ju bëni atë pyetje dhe unë ju ofroj të dhënat qoftë me gojë, qoftë me shkrim, ose jeni të mirëseardhur në Ministri çdo kohë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!
Deputetja Gjylnaze Syla, ka edhe dy pyetje, njëren për Kryeministrin, i cili nuk është këtu. A dëshironi ta shtroni pyetjen?

GJYLNAZE SYLA: Zoti kryesues,
Të nderuar deputetë,
Me qenë se konsideroj se pyetjet e mia drejtuar Kryeministrit, por edhe ministrit të Punëve të Brendshme, Pajaziti janë të rëndësishme, prandaj unë do t'i pres që në seancën e radhës t'i shtroj këto pyetje, gjithnjë duke ju ftuar juve dhe Kryesinë që të siguronin që Qeveria të jetë e përgjegjshme dhe të jetë këtu për t'u përgjigjur pyetjeve parlamentare.

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Do të përpiqemi.

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin Ahmet Shala.

RIZA SMAKA: Te nderuar kryesues, deputetë, qeveritarë,

Pyetja, zoti ministër Shala, referohet përkitazi me simptomat e rënies permanente të prodhimit të punësimit produktiv, prodhimit bujqësor, blegtoral, rënie që bile së paku këto dy segmente ishte dashur të jenë në ngritje. Kemi resurse, vetëm mungon politika qeveritare adekuate- adakte e subvencionimeve, e stimulimeve më se të ndryshme, prandaj kjo është një çështje shqetësuese mendoj jo vetëm për mua. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Profesor i nderuar,

Pyetja me shkrim, siç më ka ardhur mua është përafërsisht këtu. Pyetje kuvendore për përgjigje gojore. Zoti ministër, me konsideratë ju pyes për opinionin qeveritar dhe tuajin për çështjen, për tatëpjetën ekonomike. Përafërsisht kështu ka qenë pyetja e formuluar dhe sinjerisht them ka qenë një pyetje mjaft gjenerale të cilën vështirë se mund të jem preciz, jam përpjekur që të japë përgjigje në bazë të kuptuarit të kësaj pyetje. 5,4% ishte rritja ekonomike në vitin e kaluar, konsideroj një shifër e cila është konfirmuar edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, metodologjinë e të cilit e zbatojmë po thuaj se edhe ne. Dhe, në bazë të kësaj dhe po të shikoni një trend të shteteve në regjion konsiderojmë megjithatë që një shkallë e tillë e rritjes ekonomike nuk është për t'u zhvlerësuar nga askush, përkundrazi kudo që jemi në seanca ndërkombëtare në Evropë marrim komplimentet më të mëdha dhe kjo sigurisht u shkon për nder të gjitha politikave që janë bërë deri sot në Kosovë që duke pasur fatin Kosova , të qenit e vogël, megjithatë edhe këtë vit do të kemi një rritje ekonomike rreth 4% dhe vitin e ardhshëm po ashtu rreth 5%.

Të gjitha parametrat në regjion janë nën zero ose goxha shumë nën zero dhe kjo sinjerisht konsideroj se duhet të vlerësohet dhe theksohet. Nuk do të thotë që kjo është e mjaftueshme për të tejkaluar atë që e thatë ju me të drejtë i nderuar profesor çështjen e shkallës së lartë të papunësisë. Ne, me politikat e tona të investimeve dhe uljes së taksave, investimeve publike të cilat edhe në tri vjetër e ardhshme do të jenë jo më ulët se sa që kemi bërë në vitet e kaluara. Me hapjen e dyerve për të marrë kredi të buta në institucionet ndërkombëtare, sigurisht që shkalla e investimeve në sektorin publik dhe privat do të na mundësojë që një rritje ekonomike diku në 3 deri 5 vjetër e ardhshëm synojmë të kemi 6 – 7% dhe vetëm me këtë rritje, diku 70% do jem në gjendje që të absorbojmë një numër të madh të papunësuarve.

A do të sigurohet kjo? Në qoftë se respektohen sugjerimet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për vazhdimësinë e rritjes së investimeve publike, në vazhdimësinë e uljes së shpenzimeve qeveritare dhe në vazhdimësinë e menaxhimit të saktë të financave publike, unë mund t' ju them para jush dhe para të gjithëve, ne do arrijmë të qëndrojmë shumë lart në rritjen ekonomike edhe në vitet e ardhshme.

Prandaj, propozimet tona dhe raporti i fundit që do ta merrni nga Fondi Monetar Ndërkombëtar jep shenja të sigurt se ne jemi në rrugë të mirë që të hyjmë në program me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe të thithim edhe donacionet e shteteve perëndimore- demokratike të cilat na kanë mundësuar në konferencën e kaluar rreth 1, 2 miliardë dollarë, dhe unë kërkoj mbështetjen tuaj që vërtet këto shqetësime t'i tejkalojmë bashkë.

Deri më tani besoj që të gjitha trendët tregojnë pozitivisht dhe unë jam i bindur që në qoftë se vazhdojmë me këtë trend të rritjes së ekzekutimit të buxhetit të uljes së shpenzimeve të panevojshme në Qeverinë dhe në institucionet tona dhe të menaxhimit të saktë të politikave tona, kam një optimizëm të argumentuar se edhe në vitet e ardhshme Kosova do të mbetet lider në rritjen ekonomike në regjion. Sigurisht që do të nevojiten vite e vite për të tejkaluar ...

KRYESUESI: Zoti ministër, duhet që ta matim kohën, respektoni tre minutëshin.

MINISTRI AHMET SHALA: Jo, unë kam menduar që këtu më ndërpritet diskutimi. E ndërpreva pra. Faleminderit!

KRYESUESI: Jo, këtu nuk ndërpritet. Faleminderit, zoti ministër!
Zoti deputet, a keni pyetje shtesë? Urdhëroni.

RIZA SMAKA: Zoti ministër Shala, ju e dini që unë kam konsiderata për ju edhe si ministër edhe si profesor universitar, këtu s'ka kurrfarë dyshimi. Shqetësimi është i sinqertë, që më tangon mua si një nga qytetarët e Kosovës edhe juve më tepër se jeni ministër i përgjegjshëm, por edhe secilin prej nesh. Flas shkurtimisht. Në qoftë se marrim pasqyrën e eksportimeve edhe strukturat se çfarë ne eksportojmë, lëndën e parë e eksportojmë, kurse importojmë produkte finale. Këtë e bëjnë vetëm vendet jashtëzakonisht të prapambetura. Bujqit tanë apo katundet se unë e kam dëshirë ta dhënë katund dhe fshat, bile këtë Çabej e ka- ju lutem që kanë pasur hambarë plot e përplot e kanë shitur drithëra, sot blejnë bukë. Tokat tona pjellore të klasës së parë degradohen, devastohen, uzurpohen, ju lutem, e bleshkët tona shumë të volitshme për kulllosa e të tjera ato ...

KRYESUESI: Zoti deputet, të lutem respektoni kohën- një minutë.

RIZA SMAKA: Veç edhe një fjali. Ju lutem, bleshkët tona janë për mëkat. Dikur ka pasur familje që ka pasur 1000 krerë dele e sot nuk e ka asnjë, familjarët e atyre familjeve që janë bërë familje atomike me nga 22 tjerë, një dele nuk e kanë. Domethënë është fjala për produktivitetin si të them shkallën e punësimit produktiv edhe për krijimin e të mirave materiale në vendin tonë. Faleminderit! Kërkoj ndjesë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Lutem që atë kohën hipotetike ta matim secili edhe pse s'ka matës kur e merr fjalën. Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Mendova që këtu po ndalet mikrofonin, por do të përpiqem të jem shumë i shkurtër.

Një fjalë që e kam dëgjuar shumë të rëndësishme është se armiku nuk të dëmton në atë që ta merr, por atë që ta lenë, ndërsa po ashtu popullorçe thonë: "lufta nuk bën meremet, por bën harabatë"

Ndryshimi i strukturës ekonomike në Kosovë do ketë nevojë, një nga temat të cilat do të trajtojë edhe marrëveshja për ndihmë teknike që e nënshkruan Presidenti dhe Kryeministri para do dite me Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të mbulojë një nga politikat e zhvillimit të bujqësisë dhe fokusi i Qeverisë së Kosovës do jetë bujqësia që konsideroj është një nga degët të cilat vërtet ka nevojë për kujdes. Ne jemi duke u

përpjekur për të gjetur politika të sakta jo të subvencionimit, por forma të tjera të cilat do të bëjnë stimulimin e produkteve bujqësore dhe rritjen e prodhimtarisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Pyetja e radhës është, deputeti Naim Rustemi, nuk po e shoh deputetin këtu. Kalojmë te pyetja në vijim. Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin Ahmet Shala.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Këtë pyetje e kam bërë më 25 gusht, shpresoj që kam marrë përgjigje me kohë.

I nderuar zoti ministër, PTK-ja gjatë muajit mars të këtij viti pati dërguar në një trajnim trejavor në Universitetin e Kentit, në Britani të Madhe, 40 persona me kosto prej rreth 400 mijë eurove. Si vend trajnimi është vendosur që të marrë pikërisht vendin ku drejtori aktual i PTK-së ka punuar e gjykuar sipas Website të Universitetit të Kentit, ai edhe më tutje është punëtor atje. Me këtë rast, siç e dini, nuk janë respektuar procedurat ligjore të prokurimit dhe se ofruesi i shërbimit të trajnimit nuk është përzgjedhur me procedura të hapura. Pyetja është kjo: - Çfarë keni ndërmarrë ju si ministër lidhur me mosrespektimin e ligjit në këtë rast nga menaxhmenti i PTK-së? A keni ndërmarrë ndonjë procedurë disiplinore kundër veprimeve joligjore që po vazhdojnë të ndodhin në PTK? Nëse jo, cilat janë arsyet tuaja që nuk keni marrë masa për parandalimin e veprimeve joligjore që janë përgjegjësia e juaj, zoti ministër, si udhëheqës i ndërmarrjeve publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Zoti ministër,

MINISTRI AHMET SHALA: Në radhën e pyetjeve që kam unë në fakt nuk figuron kjo pyetje, i kam pasur dy pyetje të juaja, por megjithatë po të përgjigjem zoti Tali.

Konsideroj se duhet të sqarohet një herë e përgjithmonë, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave e Republikës së Kosovës në emër të Republikës së Kosovës mbanë të regjistruara ndërmarrjet publike të Republikës së Kosovës. Në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave ekziston Departamenti për Politika me Monitorim. Përgjegjës për respektimin e ligjit dhe procedurave në çdo ndërmarrje publike është drejtori ekzekutiv dhe është bordi i ndërmarrjeve publike. Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe Qeveria e Kosovës nuk është ministri e tipit të Stalinit ose të kushdo qoftë tjetër që të monitorojë ose mikro menaxhojë ndërmarrjet publike. Ekziston ligji, në qoftë se auditori konstaton se janë bërë shkelje ligji të cilin e keni aprovuar ju e ka shpatën e vet. Pra, secili do ta mbajë përgjegjësinë për veti, por do t'ju kisha lutur shumë që të gjitha elementet që kanë të bëjnë me mikro menaxhment nuk i takojnë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Ministria e Ekonomisë dhe Financave përcakton politikat të cilat i aprovon Qeveria e Kosovës dhe grupi ndërministror sa duhet ndërmarrjet të rristrukturohen, a duhen ndërmarrjet të privatizohen, të koncesionohen? Natyrisht ekzistojnë ligjet të cilat rregullojnë këto elemente dhe nuk kisha pasur dëshirë sinqerisht të lëshohem edhe pse përgjigja konsideroj që është përgatitur, por për sot e saktë dhe mënyrat e raportimit financiar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Pyetje shtesë, urdhëro, zoti deputet.

DRITON TALI: Po të ishim shtet, siç e do zoti ministër, për këtë përgjigje ti do të jepje dorëheqje. Lexoje Ligjin për ndërmarrjet publike, nenin 7 shumë mirë t'i qartëson

obligimet që i ke. Po të ishim shtet, dikush do ta futej në burg. Universiteti i Kentit është e vërtetë që nuk është në ato top universitetet botërore, por është universitet shumë serioz. Nuk e qet emrin e të punësuarit në ueb faqe pa qenë. Dhe, drejtori i PTK-së është edhe punëtor i Universitetit të Kentit dhe ai jep punë punëdhënësve të vetë. Kjo është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Ligjin për konfliktin e interesave. Hajnia, korrupsioni brirë nuk ka, zotëri ministër, dhe ti je edhe një herë përgjegjës. Lexoje, ligji të obligon, jo s'ke nevojë të qeshësh fare se ligji të obligon, lexoje nenin 7 shumë mirë ta shpjegon. Qysh të duash, qe po e lexoj.

KRYESUESI: Zoti deputet, një minutë, lexoje.

DRITON TALI: Po, jo, po e kërkon. Thotë kështu: Aksionari i NP-së do të ushtrojë mbikëqyrjet të vazhdueshme dhe rigoroze të veprimtarisë së Bordit të drejtorëve dhe komisioneve të auditimit të NP-së në fjalë. Ti je kryesori aksionar... O zotëri, i ke ligjet tjera, nenet tjera, pra të mos shkoj t'i lexoj, po lexoje krejt nenin 7, shumë mirë të obligon ty edhe mos harro, zoti ministër i Transportit, po ashtu, zoti Fatmir Limaj, kolegu yt të pati ngarkuar publikisht, ka thënë përgjegjës për ndërmarrjet publike, domethënë edhe për Aeroportin është ministri i Financave. Dhe, kjo është përgjegjësia juaj, i nderuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Po, urdhëro zoti ministër.

MINISTRI AHMET SHALA: Nuk mund të angazhojë një ministër një ministër tjetër në asnjë pozicion, përveç ligjit dhe përmes vendimeve gjyqësore. Ligji super thotë: "përgjegjës është aksionari". Aksionar i ndërmarrjeve publike është Qeveria e Kosovës, përkatësisht në emër të Qeverisë së Kosovës- Ministria e Ekonomisë dhe financave, e cila ka angazhuar të gjitha elementet që i ka me ligj. Komiteti i Auditimit, në kuadër të bordit të ndërmarrjeve publike është përgjegjës për të respektuar ligjin atë që e thua ti, zoti i nderuar. Nuk dua të hidhesh në komentime ligjore, por nuk i takon një ministri të merret se a e ka nënshkruar një kontratë për trajnim të 10 ose 50 vetave diku në një universitet apo diku tjetër? Ajo është çmenduri, kështu që për ndërmarrjet publike të gjitha institucionet që e respektojnë janë....

KRYESUESI: Zoti deputet, e keni shfrytëzuar mundësinë e juaj. Faleminderit, zoti ministër!

Vazhdojmë, pyetja e radhës Driton Tali, për ministrin e Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti. Ministri nuk është prezent, a doni ta shtroni pyetjen? E ke edhe një pyetje, kalo pyetjen për ministrin Shala, i cili është prezent, zoti deputet. Jo s'janë bërë ende. Ju lutem ta respektoni, domethënë kohën e paraparë.

DRITON TALI: Mandej do t'ia lexoj pasi ta respektoj më rendin.

Është një çështje mendoj shumë me rëndësi që nuk di pse ministri i Punëve të Brendshme nuk ka marrë pjesë, ... po ashtu një devijim në këtë demokracinë tonë, sidoqoftë. Siç e dimë, javë më parë në fund të gushtit aktivistët e Lëvizjes "Vetëvendosja" organizuan një protestë kundër nënshkrimit të protokollit në mes të EULEX-it dhe Beogradit me ç' rast në shenjë pakënaqësie i dëmtuan 28 vetura të EULEX-it. Në të njëjtën ditë te Kroji i Vitakut aktivistët serbë organizuan një protestë kundër rindërtimit të 5 shtëpive të banorëve lokalë të cilat ishin të djegura nga terroristët serbë gjatë gjenocidit të Serbisë në Kosovë në vitin 1999. Me këtë rast protestuesit serbë përdorën edhe armë zjarri dhe mjete shpërthyes kundër banorëve lokalë, ku si pasojë u lënduan dhjetëra civilë. Por, kundër

të rinjve të “Vetëvendosjes” policia ndërhyri dhunshëm, duke e tejkaluar shumëfish normën e dhunës. Siç jemi dëshmitarë të reportazheve televizive, policia brutalisht i shkelmonte, i goditke me grushte dhe shkopinj gome të rinjtë e “Vetëvendosjes” derisa ata ishin të shtrirë për tokë, gjersa protestuesit serbë ishin të mbrojtur nga policia vendore dhe ajo ndërkombëtare.

Zoti ministër, do të ishte shumë mirë të na tregonte se çfarë ka ndërmarrë konkretisht kundër atyre policëve brutal të cilët i kanë tejkaluar kompetencat? Nëse nuk keni ndërmarrë asgjë, atëherë pse? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër nuk është këtu, nëse dikush nga Kabineti është i gatshëm, nuk shoh dikë.

Kalojmë te pyetja tjetër. Prapë deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin Ahmet Shala. Jemi në mbarim të kohës së pyetjeve parlamentare. Deputetja Donika Kadaj- Bujupi, pyetje për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotin Idriz Vehapi. Deputete,

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Jemi dëshmitarë të shkatërrimeve të mëdha që po u bëhen pyjeve në Kosovë. Mijëra e mijëra hektarë për çdo ditë zhveshën, qoftë nga prerja e drunjëve apo nga sëmundjet e ndryshme, si pasojë e mospërkujdesjes institucionale dhe moszbatimit të ligjeve në fuqi. Për t’u riparuar këto dëme kërkojnë qindra vjet nëse fillohet sot. Pyetja është- Sa hektarë pyje janë pyllëzuar prej ardhjes tuaj në pushtet dhe ku?

KRYESUESI: Zoti ministër,

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: I nderuar zoti kryesues,

Ministra, deputetë,

E nderuar deputete Kada,

Njëra ndër komponentët kryesore të Ministrisë së Bujqësisë, përkatësisht e Agjencisë Pyjore të Republikës së Kosovës, në sferën e pylltarisë është mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale. Dhe, të gjitha këto veprime të paligjshme në pyje në pajtim me Ligjin për pyjet e Kosovës numër 2003/3, neni 7 dhe në kapitullin 7, denoncohen përmes 230 rojeve të pyjeve që mbulojnë 266 mijë hektarë në të dy sektorët, apo për çdo roje pylli 2000 hektarë në sferën e përgjegjësisë.

Në këtë aspekt po e përcjellin fletëparaqitjet e ngritura nga ana e rojeve të pyjeve për vitin e kaluar dhe për periudhën janar – gusht të këtij viti, si dhe analizën e shqyrtimit të tyre nga ana e gjykatave.

Për vitin e kaluar dhe periudhën janar – korrik të këtij viti janë ngritur gjithsej 15 mijë e 713 fletëparaqitje, prej të cilave 6750 penale dhe 8963 për kundërvajtje. Vlera e dëmit në masë drusore e shkaktuar nga prerësit ilegal është afër 36 mijë metër kub. Nëse ia bëjmë një analizë shqyrtimit të këtyre fletëparaqitjeve, situata është mjaft alarmante, ngase vetëm 15.33% e fletëparaqitjeve janë shqyrtuar nga gjykatat. Për të pasur një pasqyrë analitike rreth procedimit të fletëparaqitjeve ne juve ju kemi dërguar përmes e-mail adresës tuaj edhe një tabelë për të gjitha fletëparaqitjet që janë proceduar në gjykata dhe ato të cilat nuk janë proceduar si dhe për çmimin e masave denoncuese.

Sa u përket mbrojtjes së pyjeve konsiderojmë se sfidat në këtë drejtim gjenerohen nga problemet sociale, ekonomike me të cilat ballafaqohet Kosova dhe të cilat reflektojnë presionin e vazhdueshëm të popullatës rurale të papunë, mbi resurset pyjore.

Pastaj, mungesa e alternativave tjera për ngrohje të popullatës dhe sidomos jo stabiliteti i ngrohjes me rrymë ka bërë që tërë barra të bjerë mbi pyje për ngrohje të popullatës.

Pastaj, mos azhuriteti i gjykatave pa dashje po motivon keqbërësit ngase mungesa e gjobave adekuate nuk janë në funksion të vetëdisimit të dhunshëm të kësaj kategorie të dëmtimit të pyjeve, si dhe shumë çështje tjera të cilat janë të njohura për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Sa i përket sipërfaqeve të pyllëzuara ne vitin e kaluar kemi pyllëzuar rreth 400 hektarë me pyje, ndërkaq për vitin 2009 janë planifikuar se do të pyllëzohen edhe 800 hektarë tjerë dhe për këtë keni prapë një tabelë të cilën ne ua kemi dërguar për vendet ku është bërë pyllëzimi, si dhe për vendet në të cilat do të bëhet pyllëzimi në këtë vit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

A keni pyetje shtesë?

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Faleminderit!

Ministër, e para, ju thoni, do të thotë, në shënimet tuaja se keni pyllëzuar 300 – 600 hektarë, tash po thoni 800 në këtë vit.

Mirëpo, të dhënat nga ekspertët dhe terreni flasin që vetëm 20% të këtyre pyllëzimeve kanë sukses dhe kjo për shkak të punëve jo profesionale ose zgjedhjes joadekuate të llojit të fidanëve për terrene të caktuara. Domethënë, 80% e buxhetit të Ministrisë suaj shpenzohet apo shkon kot vit për vit. Në një raport të SIDA- s është thënë që Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural aplikon menaxhim jo profesional dhe të keq me staf të korruptuar. Prandaj, unë kërkoj të di që prej asaj 100% të pyllëzimit ku mbesin parat e taksapaguesve të Kosovës që bëjnë 80% e atij 100%, sepse veç 20% ka sukses?

E dyta, i përmendët rojet, janë 230 roje të pyllit, ju thatë 146 euro paguhet një roje e pyllit.

KRYESUESI: Deputete e nderuar, keni kaluar minutazhën për pyetje shtesë, ju lutem ta ndërpreni. Regjia ndalja fjalën.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Nuk është pagë e dinjitetshme ashtu siç keni premtuar- 146 euro nuk mund ta mbulojë territorin prej 2000 hektarëve siç thoni ju. 146 euro nuk janë subvencion për punë në kushte të vështira të cilat i bëjnë këta njerëz.

Dhe e fundit, qytetarë,

KRYESUESI: Trego më shpejtë, po s'e dita. Mirë e ke.
Zoti ministër kyçe mikrofonin, mirë.

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: Unë thashë se janë pyllëzuar gjithsej 400 hektarë vitin e kaluar dhe për atë..

KRYESUESI: Zoti ministër, vazhdo. Ju lutemi për qetësi dhe mirëkuptim.

MINISTRI IDRIZ VEHAJI: Dëgjo, tash duhet të jeni pak më të kulturuar ju lutem, sepse të gjithë e dimë se si janë rregullat. 400 hektarë janë pyllëzuar vitin e kaluar dhe 800 do të pyllëzohen në këtë vit, nuk thashë se janë pyllëzuar edhe më tej, se sa ato shkatërrohen, thahen prej kushteve të thatësisë edhe prej zjarreve, ju e dini se në vitin 2007 se sa sipërfaqe të pyjeve janë djegur. Për fat të mirë vitin e kaluar edhe këtë vit nuk kemi pasur probleme me zjarret.

Pagesat për punëtorë që ruajnë pyjet nuk i përcaktoj unë. I përcakton koeficienti dhe përgatitja profesionale shkollore e tyre. Pagat e dinjitetshme unë nuk i përcaktoj, por përcaktohen me koeficient. Edhe për vendin- roje e pyllit është koeficienti dhe për atë koeficient konkurrojnë njerëzit edhe punësohem. Dhe, unë nuk i përcaktoj shumat e pagave edhe asnjë ministër nuk i përcakton shumat e pagave. Këtë e di fort mirë, por po shet mend këtu.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Kemi edhe një minutë nga koha për pyetje parlamentare, veç ja thirra emrin Dritonit, le ta lexojë pyetjen.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Arsyeja pse e bëra pyetje për aksidentin me "Vetëvendosjen" është se po të ishim mbarë e mirë ne sot është dashur të bisedojmë për protokollin. Mendoj se është shumë më interesant si organ legjitim dhe përfaqësues i qytetarëve që jemi se sa të merrmi me tjera. Pyetja, po është edhe një rast do t'i këshilloja EULEX-in që të merren me korrupsion ku gjithkund kemi korrupsion e mos të merren me nënshkrime të protokollit..... Pyetja është kjo. Përsëri në bazë të Ligjit për ndërmarrjet publike, zoti ministër, kohë më parë zyrtarët e ndërmarrjeve më të mëdha publike si PTK-ja, por edhe të tjerat bën të ditur se kanë shpërndarë bonuse për ekspertët të cilët kanë qenë meritore për performancën e mirë të ndërmarrjeve publike.

Zoti ministër, a mund të na tregoni se në bazë të cilit ligj, rregullore udhëheqësit e NP-së kanë marrë vendime për shpërndarjen e bonusve, dhe gjithmonë përgjigju si zyrtar kryesor?

KRYESUESI: Faleminderit, deputet!

Zoti ministër, është pyetja e fundit që ta keni parasysh.

MINISTRI AHMET SHALA: E po shqyr që erdhi fundi. Driton, paske pushuar mirë gjatë ...Të lutem, Ligji mbi ndërmarrjet publike, meqë e ke përpara, të lutem mund ta lexosh, 03L-087, neni 20,4 përcakton që Komisioni i Auditimit të Ndërmarrjeve Publike të përgatisë dhe shpalosë deklaratën për politikën e kompensimit për drejtorë dhe zyrtarë të ndërmarrjeve publike. Pra, ndërmarrjet publike, meqenëse e lype ligjin, po ta jap, është 03 L-087 neni 20,4 dhe në bazë të këtij neni dhe të këtij Ligji, ndërmarrjet publike kanë të drejtë t'i japin bonuse në bazë të performancave të cilat shpalosen edhe publikisht. Ju faleminderit!

KRYESUESI IBRAHIMI GASHI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Zoti deputet, koha ka kaluar edhe ashtu për pyetje parlamentare, një minutë do ta kesh. Vazhdo, zoti deputet me pyetjen shtesë.

(Reagime nga salla)

DRITON TALI: Jo, jo 20.4 nuk qartëson kurrëgjë, zoti ministër, që do po ia lexoj opinionit publik, por ty po ta lexoj edhe 34.4 dhe 35.1, ku të obligon për ta bërë Rregulloren. Jo, qe po ta lexoj 20.4. Më falni. Qe këtu e pata 20.4, thotë: “Komisioni i Auditimit do të përgatisë dhe zbulojë në mënyrë publike një deklaratë për politikën e kompensimit për drejtorët dhe zyrtarët e NP-së”.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Koha e juaj ka skaduar. Ju ka skaduar, të lutem.

Driton Tali... hiq nuk ka problem...

KRYESUESI: Vazhdojmë me pikën e radhës, meqë tri pikat e para të rendit të ditës... Kalojmë te pika e gjashtë e rendit të ditës.

(Reagim)

Urdhëroni! Kush ju ka ofenduar publikisht. Unë nuk e vërejta dhe askush këtu nuk e vërejti se ju ka ofenduar publikisht.

Vazhdomë me pikën e gjashtë.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për turizëm dhe shërbimet turistike

Në bazë të Rregullës 35, pika 1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin në parim të këtij Projektligji. Ftoj ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, zotin Lutfi Zharku, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që shkurtimisht t’i paraqesë pikat kryesore të Projektligjit për turizëm dhe shërbimet turistike.

Projektligji ka për qëllim që të përcaktojë rregullat që zbatohen për zhvillimin e të gjitha veprimtarive të turizmit dhe të shërbimeve turistike në nivel kosovar, si dhe organizimin dhe funksionimin e institucioneve kompetente për këtë fushë. Projektligji rregullon marrëdhëniet ndërmjet institucioneve publike, personave fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj që ushtrojnë veprimtari turistike, përcakton të drejtat dhe detyrimet e subjekteve pjesëmarrëse në këto veprimtari, format e promovimit të Kosovës si vend turistik si dhe çështje tjera që lidhen me fushën e turizmit.

Projektligji rregullon procedurat e kategorizimit të hoteleve, i cili do të vazhdojë të mbajë si obligim të mëtejshëm ligjor në përputhshmëri me praktikën e vendeve të BE-së. Në përputhshmëri me vizionin tonë për eliminimin sa më të madh të licencave për zhvillim të biznesit, me këtë Projektligj eliminohet procesi i deritanishëm i licencimit të hoteleve, i cili nga analizat tona është konsideruar barrierë në zhvillimin e këtij lloji të biznesit, që është risi e këtij projektligji. Megjithatë, ne do të vazhdojmë të mbajmë

publikimin për licencimin e agjencioneve turistike, i cili proces rregullohet në mënyrë më detaje me këtë ligj. Risi tjetër në Projektligj është edhe formimi i Këshillit Kosovar të Turizmit, i cili do të ketë përfshirje të gjerë institucionale dhe komunitetit të biznesit në hartimin e politikave turistike dhe promovimin e turizmit në Republikën e Kosovës.

Projektligji përmban një kornizë rregullative të detajizuar sa i përket turizmit dhe shërbimeve turistike, si dhe eviton kolizionin, paqartësinë në mos ndërlidhjen e dispozitave të caktuara, si dhe lëshimeve teknike në Ligjin e mëhershëm për veprimtari turistike dhe hoteliere. Rëndësia e rregullimit juridik të kësaj fushe është vitale për ndërtimin e një ekonomie të bazuar në parimet e ekonomisë së tregut. Ky Projektligj do të vendos rregull më të avancuar ligjor për sa i takon turizmit në Republikën e Kosovës, duke ofruar edhe garanci juridike dhe institucionale për mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga zhvillimi, funksionimi, mbikëqyrja dhe kontrolli i turizmit.

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij Projektligji dhe duke pasur parasysh nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në lëmin e ekonomisë në përgjithësi, ju rekomandoj që këtë projektligj ta miratoni në këtë seancë plenare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër! Pas prezantimit të Projektligjit nga ana e ministrit, hapim debatin. Sipas radhës, ftoj përfaqësuesit e komisionit, nëse kanë për të thënë diçka. Nuk janë paraqitur. Vazhdojmë me grupet parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka kërkuar deputetja Safete Hadergjona.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për të gjithë deputetët,

Ne sot e kemi në shqyrtim Projektligjin për turizëm dhe shërbimet turistike. Është një ligji i rëndësishëm, i cili po ashtu rregullon një fushë të rëndësishme. Ministri përmendi në përgjithësi arsyeshmërinë e nxjerrjes së këtij ligji, kurse unë do të ndalem vetëm në disa vërejtje të cilat ne si grup parlamentar i kemi vërejtur në këtë projektligj.

Ligjet zakonisht na kanë ardhur nga Ministria Tregtisë dhe Industrisë, pothuaj se në të gjitha është paraparë formimi i një agjencioni, mandej formimi i një këshilli, që të gjitha këto këshilla, këto agjencione kërkojnë një kosto shtesë buxhetore. Edhe në këtë projektligj e kemi një kosto shtesë me numër të caktuar të punëtorëve, kurse Qeveria e ka një rekomandim që duhet të jetë shumë e vëmendshme në drejtim të shtimit të numrit të të punësuarve për arsye se kemi vërejtje edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë, por edhe gjendja në vend nuk është aq e lakmueshme në administratë. Prandaj, në këtë ligj parashihet një kosto shtesë buxhetore, e cila nuk është e paraparë me buxhet dhe e cila nuk është e paraparë as në Kornizën afatmesme të shpenzimeve, edhe pse kjo kosto nuk është edhe aq e lartë edhe është dashur të parashihet sepse është e mbulueshme, ndoshta.

Sa i përket projektligjit, ne i kemi disa vërejtje, për shembull, te përkufizimi në Ministrinë. Është mirë të përcaktohet se cila ministri është kompetente për çështjet e turizmit dhe jo vetëm të mbetet ashtu ministria që është kompetente për turizëm, sepse shkakton konfuzion a i takon kjo pjesë, kjo fushëveprimtari Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë apo ndonjë ministrie tjetër. Po ashtu kemi vërejtje edhe tek disa nene, si te neni 10 që unë mendoj, po ashtu edhe Grupi Parlamentar ka menduar se duhet

ndryshuar, sepse neni është i pakuptimtë. Mandej, ne kemi vërejtje po ashtu edhe tek gjrobat dhe mënyra e lëshimit të licencave, që mendoj se duhet bërë një punë e madhe në komision në mënyrë që këto çështje të rregullohen, kurse një çështje tjetër që mendoj që duhet diskutuar, është çështja e formimit të Këshillit Kosovar, siç thuhet këtu, të Turizmit. Ne nuk pajtohemi edhe me këtë termin Këshilli Kosovar, le të mbetet Këshilli i Turizmit apo ndonjë emër tjetër, por këtu Këshilli Kosovar është e kuptueshme dhe nuk ke nevojë t'ia shtosh termin "kosovar".

Duhet analizuar arsyeshmëria e formimit të këtij këshilli dhe, nëse vërtet mbetet që ky këshill të formohet, atëherë duhet analizuar me kujdes se në kuadër të këtij këshilli parashihen shtatë anëtarë të këtij këshilli. Pesë nga këta anëtarë zgjidhen nga ministrat e ndryshme dhe atëherë mbetet të diskutohet se sa është e arsyeshme që anëtarët e këtij këshilli t'i zgjedhë vet ministri i Tregtisë dhe Industrisë dhe nuk dihet se si do të paguhen këta anëtarë të këshillit edhe pse aty po shkruhen disa detyra të cilat kryesisht janë këshillëdhënëse për ministrin.

Ne në përgjithësi e përkrahim, mirëpo mbetet një punë e madhe të bëhet në Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Telekomunikacion, që ne mendojmë që këto probleme të cilat i diskutuam këtu, përmes anëtarëve tonë në Komision do të japim kontributin tonë që si përfundim ligji të jetë i mirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit deputete! Në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, fjalën e ka kërkuar deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

Vlerësimi i Grupit Parlamentar për Projektligjin për turizëm dhe shërbimet turistike është se, përveç nevojës të madhe që ka për këtë, është edhe për çështjet që ai i adreson dhe i rregullon brenda këtyre 45 neneve, të cilat kodifikojnë çështjet që kanë të bëjnë me veprimtari turistike, agjencitë, autoritetet dhe organet tjera kompetente për të rregulluar këtë fushë, por edhe në disa sektorë që është me rëndësi, siç është ekoturizmi apo turizmi rural, ai dimëror dhe të tjera. Vërejtje, duke lexuar pra në leximin e parë, vërejtjet tona kanë të bëjnë te kapitulli, i cili ka të bëjë me standardet, kategorizimin e objekteve hoteliere dhe autoriteti përkatës të cilin mendoj që merr pak punë. Komisioni duhet ta shikojë më mirë. Në të njëjtën kohë po ashtu ndajmë vlerësimin se ky projektligj do të mundësojë promovimin e turizmit si degë e rëndësishme ekonomike. E përkrahim në parim dhe besoj që në komisione do të japim kontributin tonë si grup parlamentar.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka kërkuar deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, i nderuari zoti kryesues!

Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Që në fillim Grupi i Aleancës, do t'i themi ministrat të Tregtisë dhe Industrisë se do ta përkrahim këtë projektligj me një qëllim që turizmi ka nevojë të zhvillohet në Kosovë, sepse turizmi sjellë përfitime të mëdha ekonomike dhe përfitime në Buxhetin e Kosovës dhe njëherësh, në kuadër të turizmit do të kemi edhe ndërmarrje të vogla, të cilat do të bëjnë një shkallë më të madhe të punësimit. Mirëpo, vërejtjet tona të cilat janë në këtë projektligj janë se projektligji më tepër merret me agjensionet turistike se sa me

promovimin e turizmit. Unë besoj që Departamenti i Turizmit që është në kuadër të Ministrisë, Tregtisë dhe Industrisë, duhet më tepër të bëjë për turizmin, duhet më tepër të bëjë promovim për Kosovën dhe të jetë më atraktive për të hajt të cilët vijnë në Kosovë. Kjo mungon dhe duhet që ky Departament, i cili një kohë të gjatë është në kuadër të Ministrisë së Tregtisë, nuk di se çka ka vepruar.

Vërejtje tjetër është edhe kostoja buxhetore. Unë besoj se me kohë duhet me këto projektligje t'i kushtojmë rëndësi kostos buxhetore për arsye se do të kemi vështirësi që të zbatohen në praktikë. Tash këtu kemi Departamentin e Turizmit, por e kemi edhe Këshillin e Turizmit dhe kemi dy mekanizma të cilët mund të përzihen në punët e njëri tjetrit edhe pse është bërë një përpjekje që të bëhet një ndarje e tillë, mirëpo duke u nisur nga praktikat e bordeve, duke u nisur nga praktikat e shumë ligjeve që kemi bërë borde e këshilla, unë besoj se dhe jam duke u frikësuar se të dytë do ta kryejnë të njëjtën punë, por shpresoj që ministri do ta ketë një kontroll edhe mbi Departamentin edhe mbi Këshillin me qëllim që të mos kenë përzierje të kompetencave.

Një vlerësim tjetër është edhe te gjrobat, te neni 10 që e përmendi deputetja, por edhe është një nen ku tek agjensionet për punësim do të kërkohet që Këshilli i Turizmit do t'ua jep një certifikatë njerëzve të cilët punojnë në ato agjencione. Mirëpo, do të shtrohet pyetja, nëse një njeri e ka fakultetin e turizmit, qysh ka përgjegjësi një këshill i turizmit, kur nuk dimë me çfarë ekspertë është, të pyet një njeri dhe t'ia jap një certifikatë, do të thotë a më vlerë ka diploma e fakultetit a ka certifikata. Mua kjo po ma çon mallin sikur zoti Çeku, kur ka qenë kryetar i komunës, më pat çua në një seminar dhe e pata marrë një certifikatë nga biznesi për një javë nga të huajt dhe të huajt i jepnin më tepër rëndësi asaj certifikate se sa diplomës së Fakultetit Ekonomik. Unë besoj se nuk duhet ta degradojmë veten dhe t'i degradojmë njerëzit tjerë të cilët kanë përgatitje shkollore akademike dhe ai nuk bën të hap agjencion, por duhet të lëshohet nga Këshilli një certifikatë për punësim në agjencion. Këto janë vërejtjet, ndërsa në parim ne si grup parlamentar do ta mbështesim dhe përkrahjen tonë do ta japim në komisionin funksional dhe në komisionet kryesore që do ta kalojnë këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit,deputet. Në emër të Grupit parlamentar të AKR-së, fjalën e ka kërkuar Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për ministrat që janë prezentë dhe për të gjithë deputetët brenda kësaj seance plenare.

Mund të them se shqyrtimi i parë i Projektligjit për turizëm dhe shërbimet turistike, Grupi i Aleancës Kosova e Re në parim e mbështet, mirëpo me përmirësimet të cilat do të bëhen gjatë punës në Komisionin Parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe Transport.

Të gjithë parafolësit e mi cekën shumë pika të cilat janë evidente edhe te Grupi Parlamentar i AKR-së, është neni 3, te përkufizimet, zoti ministër, mbasi je prezent këtu për arsye ndoshta të Zyrës ligjore, e cila e mbështet këtë Ministri, nga mosdija mund të lëshohen këto gabime. Këshilli Kosovar i Turizmit, edhe kolegja ime nga komisioni e përmendi se po na formohen shumë këshilla e shumë agjencione, tash të shohim si do të shkon puna mandej. Mandej kemi edhe te një nen tjetër. Unë do të potencoj të gjitha pikat në të cilat kemi hasur mangësi në këtë projektligj. Kemi nenin 24, shërbimet e ciceronit turistit, animatorit turistik dhe shoqëruesit turistik. Ministria lëshon certifikata.

Ministria nuk është institucion shkollor. Në bazë të profesioneve të personave të cilët janë në këtë shërbim, atëherë Ministria mund t'i jep vendet e posaçme në të cilën pjesë atakohen këta persona, se Ministria është Ministri për ekzekutim të ligjeve e jo institucion shkollor.

Mandej çështja e licencave, Ministria në pajtim me detyrimet e saj zyrtare, çdo dy vite bën rikategorizimin e objekteve hotelerike. Unë kisha për të pasur këtu një dyshim shumë të madh, qysh mund të ndodhë në çdo dy vjet të bëhet, është punë e vështirë dhe ka mundësi të korruptohen njerëzit të cilët do të bëjnë këtë rikategorizim. Edhe çështjen e gjobave kisha për ta ngritur si çështje shumë të posaçme. Ministër, aty duhet të definosh se për çka mund të gjobitet një pronar i një institucioni apo një agjencionit turistik me 1500 dhe cili me 4000, jo të thuhet shuma e ndëshkimeve do të jetë nga 1500 deri 4500 euro. Këto kishin qenë të gjitha mangësitë që i ka hasur Grupi Parlamentar i AKR-së në shqyrtimin e Projektligjit për turizëm dhe shërbime turistike. Në parim përkrahet, besoj që do të bëjmë plotësim dhe ndryshim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit Parlamentar atë LDD-së, deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Zotëri ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për turizmin dhe shërbimet turistike, duke konsideruar që me këtë ligj për herë të parë përcaktohen parimet, rregullat që e rregullojnë fushën e turizmit, por edhe standardizimin e shërbimeve turistike.

Ky ligj rregullon marrëdhënie të rëndësishme që deri më tani nuk kanë qenë të mbuluara me ligj në vendin tonë. Edhe ne si Grup Parlamentar i kemi disa vërejtje konkrete që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e Departamentit të Turizmit dhe të Këshillit të Turizmit. Duhet të qartësohen edhe mekanizmat, edhe përgjegjësitë, sepse do të keni inpakte direkte në zbatimin e këtij ligji në praktikë. Duke e ditur që zhvillimi i turizmit në vendin tonë nuk është në parametrat e dëshiruar dhe do të duhet shumë punë edhe për thithjen e investimeve të huaja direkte, që është një objektiv besoj edhe i Ministrisë, do të duhej të qartësohen edhe përgjegjësitë e Departamentit të Turizmit, të Këshillit të Turizmit Kosovar. Mund të quhet Këshilli i Turizmit i Republikës së Kosovës. Pastaj, ministër, te kategorizimet dhe standardizimet cilat janë efektet direkte në investimet e mundshme në planin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, sepse po bëhet një ligj i cili një herë e përgjithmonë duhet ta rregullojë këtë fushë dhe mos të obligohemi mbas një kohe që të bëjmë plotësime, ndryshime eventuale që nuk i kemi paraparë dhe si organi më i lartë legjislativ i vendit kemi obligim.

Një vërejtje në vazhdimësi për projektligjet, jo vetëm te Ministrisë që ju e udhëheqësi, zoti ministër, por edhe të dikastereve tjera qeveritare është mospërputhja e kostos buxhetore me Kornizën afatmesme të shpenzimeve që e kemi diskutuar dhe miratuar në këtë Kuvend. Është një kosto shtesë buxhetore për Departamentin e Turizmit për periudhën 2010-2011, e cila vlerësohet në një vlerë prej 60.052 euro. Duket një shumë e vogël në fillim, por mund të shkaktojë probleme pastaj në funksionalizimin e mekanizmave tjerë që janë përgjegjës për zbatimin e këtij ligji.

Ne si Grup Parlamentar e përkrahim në parim dhe kontributin tonë do ta japim në procedurat e mëturshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka kërkuar deputeti dhe shefi i Grupit Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Dozvolite da i ja pozdrvim vas predsedavajući, kolege poslanike, posmatrače Skupštine i da poželim uspehe u radu. Sada kada imamo izbornu godinu i nadam se da ćemo sačuvati međusobnu toleranciju jer smo ovdje vrlo odgovorni pred građanima.

Ja sam, kao i moje kolege, izašao da malo prokomentarišem Zakon o turizmu i turističkim uslugama, jedan od zakona koji reguliše novu oblast, jednu relativno mladu oblast, kažem turizam. Turizam kao posebna oblast u zemljama sa dužim razvojem spada među one privredne grane koje imaju izuzetnu perspektivu. Ja bih ovde kao primer naveo Albaniju, koja je samo ove godine, prema parametrima koje nudi javnost, imala rast u turizmu od 42%. Mi kao susedi, kao zemlja koja ne izlazi na more, to se u turizmu zove kontinentalna zemlja. Ako pogledamo zemlje kao što su Švajcarska ili Austrija, možemo da primetimo da i one zemlje nemaju ni mora ni jezera, ukoliko pristupe ozbilno ovoj prirodnoj grani, mogu da od ove grane očekuju ogromne dobiti. Međutim, u predlozima Evropske Unije, evropskog zakonodavstva, ova oblast se ostavlja da je regulišu svaka zemlja posebno ponaosob, ali se pominje da je to atraktivna delatnost kojoj treba pridati važnost i u kojoj treba više ljudi zapošljavati. Doslovce stoji u memorandumu ovoga zakona. Ako je tako, a jeste, Departman za turizam pri Ministarstvu za trgovinu i industriju, u predlogu Nacrta zakona uopšte nije predvideo recimo turističke saveze, koje je pomenuo moj prethodni kolega, izlagač Rugova, i ja se u potpunosti slažem. Ne može da postoji Turistički savez Kosova, a da ne postoji Turistički savezi u gradovima gde imamo uslove za razvoj turizma. Ja znam da Prizren, kao prvi turistički grad recimo ka Kosovu, je imao taj savez davno, davno pre rata na Kosovu. I mi sa resursima nacionalnih parkova, kakav je recimo Nacionalni park Šara ili Nacionalni park Prokleltije, imamo „Bjeshkët e Nemura“, Peć, mi nemamo u ovim gradovima. Tamo imamo 300 i nekoliko hiljada predviđenih finansijskih sredstava za jednu godinu, sa rastom od po 30-40 hiljada svake naredne godine. Nigde se ne predviđa...zaposlenih. Recimo, otvaranje takvih centara, jer se nigde ne predviđa, da recimo se naprave afiše oni listići turistički koji će propagirati to i tako dalje i tako dalje. Mislim da je mnogo vremena prošlo nakon rata i da moramo da se ozbiljnije pozabavimo ovom temom.

Ovaj Nacrt zakona u svakom slučaju prihvatamo, međutim tu ima mnogo prostora za njegovu doradu, dopunu i tako dalje, tako da mi ne trebamo biti izuzetak i da se stalno bavimo nečim što su posledice rata a da uopšte ne razmišljamo sa izlaskom iz toga i sa glavom kako regulisati jednu oblast koja nudi ljudima detaljno upoznavanje jedne zemlje, koja nudi rekreaciju, odmor i tako dalje, i tako dalje. Niko ne nudi rehabilitaciju recimo turističkih objekata koji su zamrli, zatstareli... i tako dalje. Mislim da ima dostav prostora kako bi se ova oblast bolje uredila i kako bi konačno građani Kosova mogli da razmišljaju da ne bacaju onolika sredstva u susednim zemljama, nego da ih ulaže u svoju.

Mi, dakle u načelu ovaj zakon podržavamo, ali kažem ima mnogo, mnogo prostora za njegovu doradu kako bi bio kvalitetan. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! Në emër të Grupit SLS, nuk është paraqitur ende dikush. Ka të paraqitur? Nuk ka. Konsideroj se kjo pjesa e prezantimit të shefave të grupeve është krye dhe kalojmë me diskutimet e radhës të deputetëve lidhur me Projektligjin. A ka deputetë të paraqitur? Deputeti Riza Smaka e ka kërkuar fjalën.

RIZA SMAKA: Zotëri kryesues,

Deputetë të nderuar,

Fillimisht, me kënaqësi e përshëndes ministrin që e ka kryesuar punën në dizajnimin e këtij dokumenti, vlerësoj të dobishëm, por për hir të bona fidej, qëllimit më të mirë, do t'i kisha prezantuar disa vërejtje parimore, natyrisht me synim që të bëhet ky dokument edhe më i mirë. Po e zëmë, titulli është i gjatë i panevojshëm - Ligji për turizmin dhe shërbime turistike. Turizmi i përfshin të gjitha segmentet edhe komponentet që hyjnë aty, edhe shërbimet. Shërbimet janë një spektër krejt i hollë në krahasim me këto aktivitete tjera. Definimi në këto dispozitat hyrëse, definimi është i mangët, nuk është dhënë definimi i plotë. Bie fjala, ndër tjera thuhet: “e forma të tjera”. Nuk ka forma të tjera, me këtë ligj përcaktohet nocioni, me këtë ligj përcaktohet koncepti i turizmit e më pastaj operohet edhe operacionalizohet nëpër dispozitat, nuk është ndonjë, si të them, referat i karakterit politik kjo, kjo, kjo e tjera, e tjera. Këtu nuk e toleron natyra e nomoteknikës shprehjen “e tjera”.

Komisioni për shqyrtimin e ankesave do të ishte një titull se omen est nomen, titulli e tregon edhe përmbajtjen apo jo, apo së paku do të duhej ta tregonte. Nuk është fjala për shqyrtim, është fjala për vendosje të ankesave. Se, sikundër të mbetej kësioj, sikundër të isha unë kryetari i Komisionit, unë do të kisha thënë, ju lutem, nuk jemi ne kompetent për të vendosur, na jemi për të shqyrtuar. Ama ç'është shqyrtimi, shqyrtimi është kurrgjë, e shqyrtojmë, paska pasur të drejtë, nuk paska pasur të drejtë apo pjesërisht paska të drejtë.

Komisioni për Ankesa, në definim atje, për vendosje të ankesave. Te neni 8, Agjencioni turistik, duhet të definohet se mund të jetë entitet natyral, mund të jetë entitet legal, a gjithnjë është operuar si entitet natyral, si person fizik. Mund të jetë, ju lutem, organizatë biznesore, shoqëri aksionare mund të jetë, e me përgjegjësi të kufizuara, por të pakufizuara apo mikste. Prandaj, duhet medoemos të thuhet edhe kjo.

Te ankesa, është çështje substanciale, mjet juridik i rregullt. Ne e dimë fare mirë që institucionet tona, po e zëmë, shpeshherë nuk e vendosin ankesën, fare se vendosin, jo që e vendos negativisht, negativisht do të duhej ta vendoste, nëse do të ishte e pabazë, mirëpo nuk e vendos fare, po e zëmë, ose e vendos pozitivisht apo negativisht, por në kundërshtim me ligjin, që është keq edhe negativisht edhe pozitivisht. Këtu duhet të precizohet afati, ju lutem, sepse është fjala për ligjin special, ligji special e derogon ligjin e përgjithshëm, a Ligji për procedurën e përgjithshme administrative është ligji i përgjithshëm, prandaj këtu medoemos duhet të precizohet. Afati 30 ditësh, bile thuhet afati 30 ditësh. Unë di rast, një institucion që ia kam drejtuar një ministrit, nuk është këtu, një pyetje, mocion parlamentar që është dashur ta vendos një çështje juridike brenda 48 orëve, nuk e ka vendosur për 3 vjet e 3 muaj, fare nuk e ka vendosur. Mund ta marrim me mend se çfarë i ndodhë një bujku apo një blegtori që nuk merret vesh, si të them, në juridik.

Te neni 40, po e zëmë, objekti duhet t'i plotësojë kushtet minimale. Nuk ka kushte minimale as maksimale as optimale, duhet t'i plotësojë kërkesat edhe ato taksativisht

duhet sipas enumeracionit të caktohen këto, këto edhe, ju lutem, i plotëson, i plotëson, i jepet po e zëmë leja apo licenca, aktvendimi për leje apo nuk i refuzohet edhe jepet shpjegimi. Jo kushtet minimale, se kjo vlen sikur ajo vërejtja e mëparshme.

Edhe te neni 43, paragrafi 2, alineja 3, medoemos të përcaktohet edhe limiti se ministri do t'i miratojë aktet nënligjore në afatin, jo do t'i miratojë, do t'i miratojë po se po, por afati bile së pakut lista ta definojmë ta limitojmë afatin, se sado kudo ajo dispozitë do ta obligonte më tepër. Edhe termi “gjobë” kurdoherë do të duhej të zëvendësohej me “dënim me të holla” se e ka një etimologji të një gjuhe tjetër, nuk ka nevojë të thuhet gjoba, globa vjen, apo jo, por dënim me të holla, ka dënim me burg, ka dënim me të holla, pra do të duhej “dënim me të holla”. Ju faleminderohem!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Deputetë të tjerë nuk ka të paraqitur për diskutim. Fjalën ia japim ministrit, nëse ka për të shtuar.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Faleminderit, kryesues! Unë desha vetëm një sqarim, nëse ka mundësi. Së pari, mendoj për deputeten Hadergjonaj. Qëllimi im, absolutisht unë nuk kam themeluar asnjë agjencion prej se jam ministër. Të gjitha agjencionet i kam gjetur qysh kanë qenë, unë asnjë nuk e kam themeluar. Jo, jo, unë nuk kam themeluar, i kam gjetur. Nuk kam themeluar unë agjencion, unë e kam gjetur agjencionin. E dyta. Mendimi im personal është që na duhet të kemi sa më pak agjencione, kështu që nuk punoj në kundërshtim me atë çka mendoj. Sa i përket Këshillit për Turizmin, në Ligjin aktual ekziston një dispozitë e cila e përcakton Lidhjen Turistike të Kosovës. Ajo përcaktohet vetëm me një dispozitë dhe nuk ka kurrfarë përcaktimi, cilat janë kompetencat, çka duhet të bëjë e tjera.

Të gjitha shtetet kanë organizatat nacionale të turizmit. Ne kemi propozuar një mënyrë të mesme, Këshillin e Turizmit i cili do t'i përfshijë të gjitha palët në mënyrë që të hartojë strategjinë e promovimit të turizmit, strategjinë turistike të Kosovës dhe të ndihmojë Ministrinë dhe të kemi një këshill të përbashkët apo një forum, ku i kemi edhe biznesin, edhe Qeverinë për të punuar sa më mirë për promovimin e turizmit.

Në anën tjetër, sa i përket kostos buxhetore, në kuadër të Ministrisë ekzistojnë 7 punëtorë në kuadër të Departamentit. Nuk ka kosto shtesë buxhetore, përpos kostoja shtesë buxhetore për mbledhjet eventuale të Këshillit, të cilat para janë vlerësuar në një shumë prej 8000 euro, kosto tjetër buxhetore nuk ka. Çështja e gjobave, unë e besoj se edhe ligjet tjera si ministri që i kemi sjellë, na mendojmë se Qeveria duhet të ketë një liri më të madhe në përcaktimin e gjobave, thjeshtë për shkak të asaj se nganjëherë gjobat bëhen pengesë e biznesit, nganjëherë gjobat nuk përcaktohen si duhet, kështu që besoj që Qeveria, në këtë rasat Ministria duhet të ketë një liri më të madhe të përcaktimit e gjobave në udhëzime administrative. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Nga regjia më bëjnë me dije se janë 66 deputetë prezentë dhe mund të hyjmë në procedurën e votimit të këtij ligji. Kam një kërkesë paraprake në formë të sqarimit për shkak të kushteve teknike që mos t'i numërojmë ata që janë “për”, do të fillojmë të pyesim, kush është “kundër” dhe kush abstenon. Okej, atëherë... Po, duhet numëruar votat për të evidentuar. Atëherë, kush është për Projektligjin mbi turizmin dhe shërbimet? Mbani duart më gjatë, duart lartë.

Kush është “për”?

Mirë, kush është “kundër”, a ka “kundër”?

Të abstenuar? Mirë ju faleminderit!

Regjia, mi jep ato shënime!

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim aprohet në parim Projektligji mbi turizmin dhe shërbimet turistike dhe me këtë rast, në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për auditim të brendshëm

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për auditimin e brendshëm dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportet me rekomandime të komisioneve u janë shpërndarë deputetëve. Para se të procedojmë me votim të amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Gani Koci ose përfaqësuesin nga komisioni, në këtë rast deputeten Hadergjonaj, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka përpunuar Projektligjin për auditimin e brendshëm dhe i ka propozuar këto amendamente. Ka qenë i formuar Grupi punues. Referuese e këtij grupi punues kam qenë unë, prandaj edhe po e prezantoj në emër të Komisionit.

Komisioni ka qenë i informuar për çdo punë që është bërë nga Grupi punues dhe e ka përkrahur Raportin përfundimtar të Projektligjit për auditimin e brendshëm, mirëpo në mbledhjen e fundit kemi vërejtur se janë bërë disa lëshime teknike në amendamentin 4, tek përkufizimi -Auditimi i brendshëm, në rreshtin e dytë, në vend të fjalisë: “që ofron siguri” duhet të shënohet “dhe i ofrimin të sigurisë”. Do të thotë, këtë përmirësim e ka kërkuar Komisioni të bëhet sot këtu. Kurse në amendamentin 7, neni 7, paragrafi 2, në rreshtin e dytë, pas kësaj fjale, do me thënë pas fjalës: “së dytë”, duhet të shtohet edhe në rreshtin e katërt, fjalia “e lartë” fshihet, se është e pakuptimtë ajo “lartë” që ka mbetur aty, është bërë një lëshim në këtë raportin përfundimtar, kurse po ashtu te amendamenti 7, paragrafi 4, në rreshtin e tretë shtohet fjalia: “modeli” para fjalisë “Statuti i auditivit”. Këto janë disa përmirësime teknike të cilat i ka përkrahur në mbledhjen e djeshme Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Kërkoj nga deputetët ta përkrahin këtë raport me këto ndryshime të cilat i propozuam.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional, sipas radhës së paraqitur në këtë raport.

Nga regjia shohim se kemi kuorum për të votuar, atëherë shkojmë.

Amendamenti 1

Kush është për amendamentin 1, ju faleminderit. Konstatohet se shumica janë “për”.

Kush është “kundër”?

Kush është i abstenuar? Kemi 2 abstenime, asnjë “kundër” dhe shumica “për”. Konstatohet se u votua amendamenti 1.

Amendamenti 2

Kush është “për”? Ju faleminderit,

“Kundër”? Nuk ka asnjë.

Të abstenuar? Kemi 2 abstenime, do të thënë, me shumicën “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, votohet edhe amendamenti nr. 2.

Amendamenti 3

Kush është “për”? Ju faleminderit,

Kush është “kundër”? Nuk kemi kundër.

Të abstenuar, kemi 2 prapë, do të thotë, me shumicë “për”, 2 të abstenuar dhe asnjë “kundër”, aprovohet amendamenti nr. 3.

Amendamenti 4

Kush është “për”? Ju faleminderit!

Kush është “kundër”?

Të abstenuar? Kemi prapë 2 të abstenuar, do të thotë, me shumicë “për”, 2 të abstenuar dhe asnjë “kundër”, aprovohet edhe amendamenti nr. 4

Amendamenti 5

Kush është për amendamentin nr. 5?

Kush është “kundër”? Nuk kemi kundër.

Te amendamenti nr. 5 kemi 1 të abstenuar.

Pra, me shumicë “për”, 1 të abstenuar dhe asnjë “kundër”, miratohet edhe amendamenti nr. 5.

Amendamenti 6

Kush është për amendamentin? Ju faleminderit!

Kundër amendamentit?

Të abstenuar 1, do të thotë, me shumicën “për”, 1 të abstenuar dhe asnjë “kundër”, aprovohet edhe amendamenti nr. 6.

Amendamenti 7

Kush është “për”, me ndryshimin që paraqiti këtu komisioni.

Kush është “për”? Ju faleminderit!

“Kundër”?

Abstenim 2, do të thotë, me shumicën “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, aprovohet edhe amendamenti nr. 7 me ato dy modifikimet që i paraqiti përfaqësuesja e komisionit.

Amendamenti 8

Kush është “për”?

Kush është “kundër”?

Të abstenuar? Ju faleminderit!

Me shumicën “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, aprovohet edhe amendamenti nr. 8.

Amendamenti 9

Kush është “për”?

Kundër këtij amendamenti?

Të abstenuar ndaj tij, asnjë.

Do me thënë, aprovohet amendamenti nr. 9 me shumicën e votave të deputetëve prezentë, pra me shumicën absolute të tyre, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim.

Amendamenti 10

Kush është “për”?

“Kundër”?

Të abstenuar?

Pra, me shumicën “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet edhe amendamenti nr. 10.

Amendamenti 11

Kush është “për”?

Kundër? Nuk ka.

Të abstenuar, 2. Gjithashtu, edhe amendamenti nr.11 aprovohet me shumicën “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”.

Amendamenti 12

Kush është “për”?

Kush është “kundër”? – 1.

Kush është i abstenuar – 2. Pra, me shumicën “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, aprovohet edhe amendamenti nr. 12.

Ky ishte amendamenti i fundit. Në vazhdim kërkojmë që të votohet për aprovimin e këtij Projektligji. Tash lus regjinë që t’i numërojë votat “Për”, “kundër” dhe abstenimet.

Në sallë janë 71 deputetë prezentë.

Kush është “për” aprovimin e këtij Projektligji, pra për aprovimin përfundimtar të tij? Ju faleminderit!

“Kundër”? Nuk ka.

Kush abstenon? Kemi 3 abstenime.

Me 67 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”, konstatojmë se u miratua Projektligji për auditimin e brendshëm. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Raportet me rekomandimet e komisioneve u janë shpërndarë deputetëve. Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj përfaqësuesin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime, nëse ka. Nuk është paraqitur, atëherë vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional sipas radhës në këtë raport.

Nga sa shoh, në sallë kemi numër të mjaftueshëm për të hyrë në votimin e amendamenteve. Votojmë amendamentet veç e veç.

Amendamenti 1

Kush është “për”?

Kush është “kundër”? Nuk ka.

Të abstenuar? Nuk ka.

Konstatoj se me shumicën e deputetëve prezent, shumicën absolute pa asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, votohet amendamenti nr. 1.

Amendamenti 2

Kush është “për”?

Kush është “kundër”?

Të abstenuar ndaj këtij amendamenti? Ju faleminderit!

Deputeti Bahri Hyseni, për dyshin jemi ende. Konstatoj se me shumicën absolute aprovohet edhe amendamenti nr. 2.

Amendamenti 3

Zoti Bahri Hyseni, kryetari i Komisionit për Legjislacion e ka kërkuar fjalën.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Konsideroj se komisioni funksional e ka bërë një punë të mirë dhe amendamentet janë shumë mirë të hartuara. Mirëpo, me qëllim që të mos e kalojmë pa vëmendje të veçantë, është çështja e amendamentit 3, ku thuhet: “Kushdo që shkakton zhurmë të panevojshme dhe të padurueshme që dëgjohet te banorët përreth apo në rrugë, që shqetësojnë personat e tjerë nga ora 22,00 e deri në orën 7,00 gjatë ditëve të javës dhe prej orës 23, 00 deri në orën 7,00 të shtunave dhe të dielave, dënohet për kundërvajtje”. Konsideroj që duhet të kemi kujdes, sepse aktualisht të gjitha kuvendet komunale e kanë nga një rregullore që e kanë nxjerrë për çështjen e zhurmës. Shumë lokale kanë leje legjitime nga komunat përkatëse, por në anën tjetër e kuptojmë që edhe banorët janë shumë të shqetësuar për shkak të zhurmave. Ka qenë dashur ndoshta komisioni, ne nuk kemi pasur mundësi t’i shohim këto amendamente, sepse ju e dini se ka qenë edhe një raport që është shpërndarë me një defekt teknik, por duhet të kemi kujdes që, nëse e aprovojmë këtë amendament kështu, unë me plot përgjegjësi po them se ky amendament nuk do të implementohet asnjëherë në praktikë, por edhe do të jetë, në anën tjetër do të jetë diçka jo shumë reale për bizneset, për njerëzit të cilët i kanë lejet, por edhe për çështje të caktuar kur dikush dëshiron dikujt t’ia bëjë një kundërvajtje, të paguaj.

Unë po e ngreh si shqetësim, atëherë le të shkon, duhet të specifikohet.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Ne e kemi propozimin e komisionit, ka kërkuar fjalën zoti Ardian Gjini lidhur me amendamentin nr. 3.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe unë mendoj sikur zoti Hyseni se duhet të kemi kujdes me këtë amendament për shkak se, nëse e hedhim në ligj një provizion i cili e përcakton kohën për çfarëdo zhurme, kemi për të pasur probleme serioze. Këto janë çështje të cilat rregullohen në zona të ndryshme dhe në vende të ndryshme dhe mendoj se si amendament mund të shkojë, të ndërrohet krejt në fakt, do të shkojë në sistemin që kushdo që shkakton zhurmë të panevojshme, dënohet për kundërvajtje. Do të thotë, çka konsiderohet zhurmë në vende të ndryshme, është shumë relative dhe nuk guxojmë ta përcaktojmë me ligj se muzika diku konsiderohet zhurmë, diku nuk konsiderohet zhurmë, shembull ta marrim, dhe dikush mund të ankohet ose të mos ankohet. Unë besoj që duhet të sanksionohet si kundërvajtje zhurma e panevojshme, por jo që të ketë provizion ligjor i cili nuk mund të ndryshohet aty e tutje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ne jemi në leximin e dytë, mos të harrojmë. E kemi propozimin e komisionit dhe e hedhim në votim propozimin e komisionit. Atëherë, nëse...

(Reagime nga salla)

... nuk ka debat. Sqarimi është dhënë, në komision është dashur, zoti.... Po mirë, është dashur grupet parlamentare me komisionet të punojnë në këtë ligj. Atëherë, është dashur këto vërejtje në komision, i nderuar. Të nderuar, unë e hedh në votim amendamentin, versionin e komisionit dhe ai mos të kaloj. Nuk është problem, veç...

Vazhdojmë me amendamentin 3

Propozimi i komisionit.

Kush është “për”? Ju faleminderit!

Le të numërohen edhe një herë kush është “për”? Ju faleminderit!

Kush është kundër?

Kemi vetëm 2 “kundër”. Të abstenuar? Me 4 abstenime, 2 “kundër” dhe shumicën “për”, konstatoj se edhe amendamenti numër 3 u aprovua.

Amendamenti 4

Kush është “për”? Shumica është “për”.

Kush është “kundër”?

Të abstenuar në amendamentin 4, nuk ka. Konstatoj se me shumicë aprovohet amendamenti numër 4.

Amendamenti 5

Kush është “për”? Ju faleminderit!

Kush është “kundër”?

Të abstenuar? Ju faleminderit! Do të thotë, me shumicën “për” dhe asnjë “kundër” dhe asnjë të abstenuar, edhe amendamenti numër 5 u aprovua.

Amendamenti 6

Kush është “për”? Ju faleminderit!

A ka “kundër”?

Të abstenuar? Ju faleminderit! Konstatohet se me shumicën absolute u aprovua edhe amendamenti nr. 6.

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin e Projektligjit me amendamentet e miratuara.

Kush është “për”?

“Kundër”? Nuk ka.

Të abstenuar – 2.

Konstatohet se me 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike. Ju faleminderit.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për armët

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për armët dhe Kuvendi i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Raportet me rekomandimet e komisioneve u janë shpërndarë deputetëve. Para se të procedojmë me votim, ftoj përfaqësuesin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, që para deputetëve ta arsyetojë raportin. Nuk ka. Vazhdojmë edhe këtu me... Po, urdhëro zoti Smaka, por shkurt, ju lutem.

RIZA SMAKA: Zotëri kryesues!

Në këtë dokument, me datën 21 prill 2009, i kam adresuar tetë projekt amendamente. Shumica e tyre janë miratuar nga komisioni, ama nuk figuron, si të them, autori. Unë mendoj se duhet të jetë për hir të dokumentacionit, apo jo. Evidenca le të jetë, apo jo. Kjo është praktikë legjislative, ju lutem, është praktikë legjislative. Nuk është fjala për çkado qoftë, por është fjala për rregullat elementare në legjislativ. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Ne e kemi marrë si raport final të komisionit. Sigurisht që në procesverbal dhe transkript është autorësia e propozuesve të amendamenteve. Vazhdojmë, nëse nuk ka të paraqitur të tjerë. Nuk ka sigurisht, se jemi në lexim të dytë. Vazhdojmë me aprovimin e amendamenteve.

E kemi këtë raport. Po votojmë për raportin e komisionit me amendamentet, prandaj shkojmë.

Amendamenti 1

Kush është “për”? ju faleminderit!

“Kundër”?

Të abstenuar? Nuk ka. Konstatohet se me shumicën absolute u aprovua amendamenti numër 1.

Për amendamentin 2, është paraqitur për diskutim anëtari i Kryesisë, zoti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Në variantin e parë të ligjit, ju e keni atje, zbutësi ose mbytësi i zhurmës, do me thënë varianti ka qenë i papërcaktuar. Komisioni është përpjekur ta bëjë një kalk në mes shqipes dhe serbishtes dhe ka bërë dy variante “mbytës i zhurmës”, “ngulfatës i zhurmës” që ka a bërë prapë në kalk serbokroatisht “prigushivać buke”. Kjo ekziston në tri variante “selenciator” nëse doni ndërkombëtar, “shurdhues” shqip dhe “prigushiva” serbisht. Unë mendoj që është varianti me një fjalë më i saktë për një pe.

KRYESUESI: Pra, e kemi propozimin që në vend të fjalës: “mbytës” sa e kuptova, të jetë fjala “shurdhues i zhurmës”, “shurdhues”. A pajtoheni me këtë modifikim që ta aprovojmë amendamentin e komisionit.

Kush është “për”? Ju faleminderit!

A ka “kundër”?

Të abstenuar? Konstatoj se edhe amendamenti numër 2 me këtë modifikim u miratua me shumicë absolute.

Amendamenti 3

Kush është “për”? Ju faleminderit!

Kundër amendamentit nr. 3?

Të abstenuar ndaj amendamentit nr. 3 ?

Konstatoj se me shumicën absolute aprovohet edhe amendamenti numër 3.

Amendamenti 4

Kush është “për”? Ju faleminderit!

Kundër këtij amendamenti?

Të abstenuar ndaj tij? Konstatoj se me shumicë absolute u aprovua edhe amendamenti numër 4.

Amendamenti 5

Kush është “për”? Ju faleminderit!

A ka “kundër”?

Të abstenuar? Konstatoj se me shumicën absolute u miratua edhe amendamenti numër 5.

Amendamenti 6

Te amendamenti 6 është paraqitur për diskutim kryetari i Grupit Parlamentar të AKR-së, zoti Makolli.

IBRAHIM MAKOKLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Propozoj që amendamenti numër 6 të fshihet si është kështu, sepse thuhet: “Blerja e armës së zjarrit për gjueti do të përfshinë dëshminë që është anëtar i certifikuar i Shoqatës së Gjuetarëve”. Është njëjtë sikurse të kesh në shtëpi një top të lojës, duhet të jesh anëtar i ndonjë grupi sportiv. Unë po propozoj, sepse kësi soji kjo ka mbetur, ju lutem, më lejoni ta arsyetoj unë pastaj. Kjo ka mbetur nga e kaluara, nga koha e komunizmit, kur shoqatat e gjuetarëve, të tilla shoqatat e gjuetarëve kanë jetuar në kurriz të anëtarësisë. Nëse njeriu mund ta posedojë armën e gjuetisë në shtëpi, nuk mund të dalë në gjueti pa lejen e Shoqatës së Gjuetarëve, por nuk mund t’ia ndalojë që të ketë armë të gjuetisë në shtëpi, sepse është njëjtë sikurse të shkosh në peshkim, duhet të jesh anëtar i Shoqatës së Peshkatarëve për të pasur të drejtë ta blesh një grep. Është e njëjtë absolutisht, është konflikt interesi dhe unë e di, keni pasur gjëra të tilla, por është nga e

kaluara në kohën e komunizmit kur gjithçka është dashur të kalojë përmes disa dyerve të ngushta. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të komisionit, e ka kërkuara fjalën zëvendëskryetari i komisionit, zoti Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI: Ju faleminderit!

Është debatuar në komision për këtë nen shumë. Ekziston ky debat në mes, në shoqërinë civile, do me thënë, edhe te Shoqata e Gjuetarëve. Shoqata e Gjuetarëve ka kërkuar madje që ky nen të jetë pak më i fortë, që thotë ky, thuhet aty që anëtar i certifikuar dhe aktiv i Shoqatës së Gjuetarëve. E shumë kush që ka qejf të dalë ndonjëherë në gjueti, nuk mundet të jetë aktiv, kështu që këtë “aktiv” kemi mbërrirë ta heqim. Po, pjesa tjetër me shumicë votash ka kaluar. Do me thënë, nuk është dëm i madh i nderuari Makolli, që të bëhet një herë certifikimi te Shoqata e Gjuetarëve, kjo nuk do me thënë se ke për të qenë gjuetar aktiv, kjo nuk do me thënë se ke për çdo vjet të paguash anëtarësinë. Ti je i certifikuar te Shoqata e Gjuetarëve, mandej çka bën ti, është punë e jote, a del në gjah, a shkon në shoqata të gjuetarëve, është tjetër punë. Do me thënë, nuk bëhet fjalë për pagesë për çdo vjet ose nuk bëhet, por për certifikim - po.

KRYESUESI: Jemi në lexim të dytë. Mirë, e ke fjalën, ta ka përmendur emrin. Një minutë. Nuk ka debat, jemi në lexim të dytë, a kuptoni.

IBRAHIM MAKOLLI: Okej, ne po nxjerrim ligje dhe besoj se duhet të shqyrtohen drejt. Unë e kuptoj, nuk është çështja e të drejtave të njeriut, e kuptoj esencën drejt. Për të qenë anëtar i një shoqate, duhet paguar anëtarësi, a po? Dhe, në momentin që ti nuk pagan anëtarësi, për të jetuar disa burokratë, ti e humbë të drejtën e lejes së armës. Leje të armës mund të ketë njeriu, por nuk mund të jetë gjuetar, nuk mund të dalë në gjah po që se nuk është certifikuar nga shoqata. Është njësoj sikurse avokat. Njeriut nuk mund t’ia ndalosh të bëhet avokat, por nuk mund ta ushtrojë profesionin nëse nuk është anëtar i Odës së Avokatëve, por avokat mund të bëhet dhe këtu është esenca, nuk është diku tjetër absolutisht.

KRYETARI: Ardian Gjini!

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Nuk është çështja vetëm e asaj se a duhet për të qenë në shoqatë a jo, por na lind një pyetje tjetër. Shoqata është organizim vullnetar. Sa shoqata kemi të drejtë t’i kemi, shembull, sa shoqata të gjuetisë? A kanë të drejtë një grumbull gjuetarësh ta krijojnë një shoqatë të re të gjuetisë dhe a mos ndoshta duhet të centralizohen në një shoqatë të gjuetisë. Nëse e centralizojmë një shoqatë të gjuetisë, atëherë jemi kthyer para 30 vjetësh. Është pyetje shumë esenciale. Nëse duam t’i lëmë të jenë anëtarë të një shoqate, atëherë duhet shënuar - anëtar i një shoqate, jo i shoqatës, se atëherë ne duhet ta formalizojmë vetëm një shoqatë të gjuetisë në Kosovë, e ajo është vetëm shkelje e të drejtës për organizim edhe për grumbullim të qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESEUESI: Ju faleminderit! Zoti Bahri Hyseni, në emër të komisionit funksional, po mendoj?

BAHRI HYSENI: Jo, unë mendoj vetëm ta sqaroj. Është një rregullore që është regjistruar Shoqata e Gjuetarëve dhe për ta blerë armën, gjithsesi duhet pasur një dokumentacion që ta lëshon shoqata. Prandaj, duhet përkrahur komisionin funksional, sepse kanë pasur të drejtë. Aktualisht pse duhet, sepse është një rregullore në fuqi që pa leje të shoqatës, pa një konfirmim të shoqatës, nuk ke mundësi as ta blesh pushkën për gjueti dhe të dalësh për gjah. Është në rregull.

KRYESUESI: Naim Maloku, e ka kërkuar fjalën. Është këtu së pari nga Komisioni dhe rendi është kështu.

NAIM MALOKU: I nderuar, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Është mirë që të debatohet për këtë nen dhe për këtë amendament për shkak se nuk kemi të bëjmë me top futbollit ose grip për peshq, por për armë. Dhe, sipas Ligjit për gjuetinë, çdo shoqatë e gjuetarëve që është e regjistruar është e obliguar në bazë të ligjit të mbajë evidencën për armët e gjuetisë së shoqatës, pastaj evidencën e kontrollit teknik periodik të atyre armëve. Pra, evidencën e gjuetarëve – poseduesve të armëve se a janë të certifikuar për të përdorur atë armë dhe unë ju propozoj të nderuar deputetë që ta votojmë amendamentin numër 6 që e ka propozuar komisioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Maloku!

Kemi dy propozime. Shkojmë së pari në votim të propozimit të komisionit dhe propozimin për ta hequr krejt, të zotit Makolli.

Kush është për propozimin e komisionit, amendamenti numër 6, sipas propozimit të komisionit.

Kush është “për”? Faleminderit!

Kush është “kundër”? Të numërohen votat, ju lutem!

Kush abstenon? - 4.

Konstatohet se me shumicën e votave “për”, 8 “kundër” dhe 4 të abstenuar, Kuvendi miratoi amendamentin numër 6 të komisionit funksional.

Vazhdojmë me amendamentin numër 7.

Kush është për? Faleminderit!

Kundër amendamentit numër 7? - 1.

Të abstenuar? Nuk ka.

Konstatohet se me shumicën “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, aprovohet edhe amendamenti numër 7.

Amendamenti numër 8.

Kush është “për”?

“Kundër”?

Abstenime?

Konsiderohet se me shumicë absolute, u aprovua edhe amendamenti numër 8.

Amendamenti numër 9.

Kush është “për”? Faleminderit!

“Kundër”?

Të abstenuar?

Pra, me shumicën absolute, u miratua edhe amendamenti numër 9.

Amendamenti 10.

Kush është “për”? Faleminderit!

“Kundër”?

Abstenim? Nuk ka.

Konstatohet se me shumicën absolute, u miratua edhe amendamenti numër 10.

Amendamenti 11.

Kush është “për”? Faleminderit!

“Kundër”?

Abstenim?

Konstatohet se edhe amendamenti numër 11 u miratua me shumicën absolute të deputetëve të pranishëm.

Amendamenti 12.

Kush është “për”? Faleminderit!

“Kundër”?

Abstenim?

Edhe amendamenti numër 12 u aprovua me shumicën absolute.

Vazhdojmë me amendamentin 13.

Kush është “për”? Faleminderit!

“Kundër”?

Abstenim? 1.

Konstatohet se me shumicën “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, u aprovua edhe amendamenti numër 13.

Amendamenti 14.

Kush është për? Faleminderit!

“Kundër”?

Abstenim?

Konstatohet se edhe amendamenti numër 14 me shumicën absolute u miratua.

Amendamenti 15.

Kush është “për”? Faleminderit!

“Kundër”?

“Abstenim”? -1.

Pra, me shumicën “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, u miratua amendamenti numër 15.

Amendamenti 16.

Kush është “për”? Faleminderit!

“Kundër”? Asnjë.

Abstenim? -1.

Me shumicën “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin numër 16.

Amendamenti 17.

Kush është “për”? Faleminderit!

“Kundër”?

Abstenim? -1.

Konstatohet se me shumicën “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 17.

Amendamenti numër 18.

Kush është “për”? Faleminderit!

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? -1.

Kuvendi me shumicë aprovoi, me 1 abstenim, edhe amendamentin 18.

Amendamenti numër 19.

Kush është “për”? Faleminderit!

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? -1.

Konstatohet se edhe amendamenti numër 19 u aprovua me shumicën “për” dhe me 1 abstenim.

Amendamenti 20 dhe i fundit.

Ftoj deputetët të votojnë.

Kush është “për”? Faleminderit!

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? -1.

Pra, me shumicën “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, u aprovua edhe amendamenti numër 20, i fundit në këtë projektligj.

Shkojmë me votimin e Projektligjit në përgjithësi, me amendamentet.

Lus regjinë që të përcjellë dhe numërojnë votat.

Kush është për miratimin e Ligjit për armët? Faleminderit!

“Kundër”? Asnjë.

Abstenim? -1.

Pra, me 64 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për armët. Faleminderit!

Pika e fundit e seancës së sotme është pika e dhjetë:

- Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit

Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin për telekomunikacionit i ka propozuar anëtarët e Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit.

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës të Kuvendit e ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë dhe ka rekomanduar për miratim në seancë plenare.

Propozim-vendimi i Qeverisë me dokumentacion dhe rekomandimi i Komisionit u janë shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetaren e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, zonjën Muzejene Selmani, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime. E keni fjalën, zonja Selmani!

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në pajtim me Rregullën 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me datën 21.07.2009 shqyrtoi Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Numër 0270 të datës 25.06.2009 lidhur me propozimet e emërimit të anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të telekomunikacionit të Kosovës dhe nxori përfundimin:

Miratohet Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Numër 0270 i datës 25.06.2009 lidhur me propozimin e anëtarëve të Bordit të ART, si vijon:

- Ekrem Hoxha, kryesues,
- Lulzim Kurtaj, anëtar,
- Besnik Bardhi, anëtar,
- Naser Shala, anëtar,
- Nijazi Ademaj, anëtar

Dhe, njëkohësisht i rekomandohet ky propozim Kuvendit që ta japë fjalën e fundit për këtë Bord të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Kërkoj deklarin e kryetarëve të grupeve parlamentare. Vazhdojmë me Grupin e PDK-së. Nuk është paraqitur askush nga ky grup, por janë “për”. Grupi Parlamentar i LDK-së. Edhe këta e mbështesin. Kur të kalojmë te deputetët, zoti Morina, do ta merrni fjalën. Grupi Parlamentar i AAK-së Ardian Gjini, shef i Grupit.

ARDIAN GJINI: Faleminderit edhe një herë, zoti kryesues! Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk e mbështet këtë propozim për Bordin e Agjencionit Rregullativ të Telekomunikacionit. Duhet të them se nëse do të kishim votuar veç e veç për anëtarët, ndoshta edhe dy të parët do të ishin mbështetur, po them ndoshta, mirëpo kur e shohim Bordin si të tillë, si të tërë, mendojmë se edhe një herë pushteti aktual në një bord kështoj ka sjellë njerëz për shpërblime të drejtpërdrejta politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Muzejene Selmani.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit zotëri kryesues! Propozim-vendimin e Qeverisë për votimin e Bordit të ART-së, Grupi Parlamentar i AKR-së, unë edhe në komision parlamentar nuk e kam përkrahur. Pikësëpari, në këtë bordin e mëparshëm dhe në Autoritetin Rregullativ të Telekomunikacionit asnjëherë s’është marrë një vendim as nga vetë komisioni, të cilin e udhëheq unë, as nga vetë raporti i cili ka dalë në këtë Kuvend në fund të sesionit pranveror, të shihet çfarë evazioni fiskal i ka bërë dëm ky autoritet rregullativ i telekomunikacionit buxhetit të Kosovës.

Së dyti, anëtarët e propozuar të këtij bordi shkelin drejt në Ligjin e telekomunikacionit, ku Ligji i telekomunikacionit mjaft mirë e thotë se dy anëtarëve të bordit të kaluar duhet t’u vazhdohet mandati dhe tre anëtarë tjerë të propozohen nga Qeveria. Me këto

propozime shihet se vetëm Lulzim Kurtaj është anëtar i bordit të mëparshëm, duke marrë parasysh se edhe ai bord në kohën e kaluar nuk ka punuar si bord i plotësuar gjithsej.

Dhe, duke parë se është shkelur ligji, Grupi Parlamentar i AKR-së nuk e përkrah Propozim-vendimin e Qeverisë për formimin e Bordit të ART-ës.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Nuk është hera e parë që Qeveria merr vendime duke shkelur në mënyrë flagrante legjislacionin që është e obliguar ta respektojë. Ju lutem, shikoni Ligjin për telekomunikacionin, shikoni me vëmendje nenin 6 alineja 5. Unë nuk e di si ka mundur komisioni funksional t'ia sjell Kuvendit për votim një vendim antiligjor. Unë kërkoj nga përfaqësuesit e koalicionit qeverisës dhe po e them publikisht para qytetarëve të vendit që nëse ky propozim-vendim i Qeverisë kalon, e merr votën e ne deputetëve si përfaqësues të popullit dhe si organi më i lartë legjislativ i vendit, atëherë nuk e di pse po bëjmë ligje, pse hartojmë ligje, pse flasim për ligje.

Ju lutem, bordi i kaluar, gjegjësisht kryesuesi i bordit të kaluar e ka fyer këtë parlament, nuk ka ardhur as të raportojë si duhet. Duke marrë parasysh veprimtarinë e lirshme të operatorëve ilegalë në territorin e Republikës së Kosovës, në thyerjen e brezit frekuencor dhe në një evazion fiskal që mund të llogaritet me qindra milionë euro, koalicioni qeverisës, një njeri që ka padi penale në prokurori, dy e më shumë, Fatmir Sejdiu dhe Hashim Thaçi e çojnë ambasador të Republikës së Kosovës në një shtet mik dhe shumë të rëndësishëm në Lubjanë.

Unë i bëj apel publik shefit të Zyrës Civile Ndërkombëtare zotit Piter Feit dhe përfaqësuesve të ICO dhe përfaqësuesve të ambasadave të vendeve të Kuintit këtu, nëse ky bord votohet si i tillë dhe shkelet Ligji për telekomunikacionin, atëherë këtu nuk ka ligjshmëri, atëherë edhe raportet e Komisionit Evropian dhe të mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë, por edhe investitorët e mundshëm në fushën e telekomunikacionit nuk di kush u garanton diçka dhe çka kërkojnë ata në Kosovë.

Zoti kryesues,

Unë kërkoj dhe do të ishte mirë që të jetë Kryetari i Kuvendit këtu, por nuk është as ministri i Transportit dhe Post-Telekomunikacionit dhe as zëvendësministri, që është edhe deputet, që ky vendim i Qeverisë të tërhiqet dhe të sillet vendimi konform ligjit në fuqi. Përndryshe, po e fusim ligjin, po e amendamentojmë, vetëm le të respektohet ligji dhe asgjë më tepër.

Edhe një herë, nëse kjo listë e tillë, nuk duam të flasim për emra, ne e përkrahim në parim, le të respektohet ligji. Nëse partnerët e koalicionit, formalisht që i kanë numrat, e kalojnë këtë vendim, atëherë unë nuk di çka kërkojmë ne këtu si deputetë dhe në çfarë kornize ligjore po punon Parlamenti i Republikës së Kosovës. Nuk jemi më IPVQ, jemi shtet dhe kërkoj që mos të shkelet ligji me vetëdije. Ju faleminderit! Ne nuk do ta mbështesim si Grup Parlamentar i LDD-së.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”? Regjia, thuhet se nuk ka për momentin përkthim. Do të thotë, nuk ka të paraqitur. Nga Grupi i

SLS, po ashtu nuk ka të paraqitur. Vazhdojmë me radhën e deputetëve që janë paraqitur këtu tek unë. Deputetja Edita Tahiri e ka fjalën, le të përgatitet Driton Tali.

EDITA TAHIRI: Ju përshëndes të gjithëve! Uroj të keni pushuar mirë në këto pushime. Do të diskutoj në cilësinë e ish-kryetares së Komisionit për Telekomunikacion të viteve 2001-2004, të njeriut i cili bashkë me të tjerët ka punuar në hartimin dhe miratimin e Ligjit për telekomunikacion dhe do t'ju them që ART-në e kam përcjellë me shumë kujdes për shumë arsye, por veçmas pse telekomunikacioni është një interes strategjik për Kosovën, i cili bie shumë profite për vendin, por bie profite atëherë kur njerëzit punojnë me nder dhe me ligj. Në momentin kur shkelet ligji, atëherë profitet në vend që të shkojnë në buxhetin e shtetit, shkojnë në xhepa personale.

Parregullsitë që i ka pasur ART-ja në këtë periudhë dhe ka vepruar e pavarur madje thua se ka ardhur prej hënës, janë shumë të mëdha. Unë do t'ua përmendi dy-tri sa për ilustrim. E para, ka pasur shkelje të ligjit në kohën kur është licencuar operatori i dytë mobil IPKO. Ka pasur shkelje të ligjit kur ART-ja kundër asaj çka shkruan në ligj, ka krijuar statut për veten dhe ia ka ndërruar cilësinë kryesuesit të Bordit, e ka bërë drejtor ekzekutiv dhe drejtori ekzekutiv ka uzurpuar kompetencat e Bordit dhe më kurrë nuk e ka konsultuar për vendime të mëdha. Çka është më e keqja, ne si Kuvend kurrë nuk morëm pra vendim që të bëjmë një komision hetimor për t'i parë këto punë dhe për të vendosur një ligj, sepse në qoftë se lejojmë që sot ta bëjmë bordin e ri dhe bordi i ri po i trashëgon të gjitha këto shkelje, edhe këta njerëz që po i biem në bord po i dëmtojmë, po më së shumti po e dëmtojmë Kosovën.

Ju lutem, është me rëndësi tepër, para se të marrim vendim për këtë punë, të bëjmë komision hetimor, si Parlament, të shohim çka ka ndodhur, pastaj pastrojmë situatën, dalim te faza e dytë. Faza e dytë është pastaj kjo që po duam ta bëjmë sot. Përndryshe, këto që i thanë kolegët, edhe Qeveria, por më shumë Komisioni parlamentar për Telekomunikacion, qysh keni guxuar ta miratoni këtë bord kur është shkelur prapë ligji. Aty shumë qartë thuhet se duhet Bordi të ketë një kontinuitet me dy anëtarë të Bordit, ndërsa këtu nuk i keni. Bordi i parë, tash ua lexon emrat kush kanë qenë dhe kush janë në bordin e ri. Në bordin e parë kanë qenë Anton Berisha, Lulzim Kurtaj, Sejd Tolaj, Aziz Sefedini dhe Ilir Dugolli, i cili në ndërkohë ka dhënë dorëheqje. Në këtë përbërje keni vetëm njërin prej këtyre, më duket është Lulzim Kurtaj.

Dhe, për fund, po ua them një praktikë çka po na ndodhë ne si shoqëri dhe si mendim institucional. Ju lutem, deri kur do të shkojmë me praktikën që një lider i një institucioni bën gabime, dështon dhe avancohet më tutje. Në këtë rast e kemi rastin e Anton Berishes, por kemi edhe raste tjera, s'dua t'ua përmendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Driton Tali, është paraqitur pas tij deputeti Numan Baliq.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ndonëse parafolësit e mi i prekën disa pika shumë të rëndësishme, unë sinqerisht do t'ia rikujtoja edhe një herë EULEX-it për çka është ftuar këtu. Nga seanca e 4 shkurtit të vitit 2008 të Komisionit Evropian shumë mirë e dinë detyrën e tyre pse janë ardhur në Kosovë: për ta luftuar korrupsionin dhe ky është një rast tipik me të cilin duhet të merren zyrat ndërkombëtare e jo me protokolle. Protokollet, sipas Kushtetutës i nënshkruan Qeveria e Kosovës.

Siç e dimë, të nderuar, ky bord, ta shtoj edhe atë që e tha para folësja – kurrë nuk ka qenë i konstituuar, për shkak se Ilir Dugolli ka dhënë dorëheqje menjëherë. Dhe, sipas Ligjit mbi telekomunikacionin, Bordi i ART-ës jep licenca. Janë dhënë 40 licenca deri më tani, afërsisht dhe të gjitha i kanë dhënë këto komisionet, kurrë Bordi s'ka dhënë. Do me thënë, këtu me theks të posaçëm është edhe licenca e Operatorit të dytë mobil.

Pastaj, shihni, personi i cili është përgjegjës për garancionin e Kosmosel-it, edhe aty janë 16.2 milionë euro, që s'dihet sot e atë ditë ku kanë mbetur. Zoti Lulzim Kurtaj, i cili ka qenë kryetar i Komisionit vlerësues, na kandidohet këtu për bord të ri. Shih ti! Personi, me të cilin duhet të merren organet gjegjëse hetimore edhe njëherë i jepet... pos ambasadorit që e kemi çue, i jepet edhe një shans për të na i humbur edhe nja 16 milionë tjera, a 20 milionë. Domethënë, ende pa u qartësua mirë puna e 16.2 milionë, unë e di se disa kanë bërë më shumë miliona dhe 16 milionë për ta s'janë... por po flas si qytetar i Kosovës që 16 milionë janë shumë të mëdha për neve.

Pastaj, veç merreni dhe shikojeni Bordin e ri. Unë s'di se a përcjellin mediat a jo. Zoti Ekrem Hoxhaj, dihet se ka qenë i kompanisë Devolli, domethënë ka qenë i punësuar nga devolli dhe tash na paraqitet këtu si kryetar i Bordit. Devolli, për ata që s'e dinë, është aksionari kryesor i Dardafonit, i operatorit virtual që e ka marrë një tender shumë të shijshëm... për të vepruar dhe ky është konflikt i interesit. Unë sinjerisht e thërras EULEX-in por edhe organet tjera të zyrave ndërkombëtare, të miqve ndërkombëtarë, le të na tregojnë se me të vërtetë janë miq dhe le të bëjnë hulumtime këtu pasi drejtësia e Kosovës ka dështuar në këtë rast. Ju faleminderit! Ky është rast për polici, nuk është për t'u marrë Parlamenti me këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Numan Baliq, le të përgatitet Lulzim Zeneli.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zoti kryesues!

Ja bih htio samo da istaknem nekoliko stvari koje su više principijelne naravi i tiću se dva pitanja, odnosno dvije primedbe koje smatram vrlo važnima. Prva je ova koja je na fonu ovoga što smo do sada čuli i koja se tiče opšteg intersovanja celokupne javnosti i gradjana Kosova, svih političkih partija, institucija i svih nas poslanika koji se ovde nalazimo. S obzirom da je oblast telekomunikacije izuzetno važna za sve gradjane Kosova, za sve zajednice, za sve nacionalnosti koje žive na Kosovu, upravo evo razlog zašto moramo biti zainteresovani ali i drugi razlog da moramo biti uključeni u ovo pitanje.

Ovde u Parlamentu je stvorena navika ignorisanja pojedinih političkih subjekata, zajednica, raznih predstavnika, interesnih grupa na račun favoriziranja onih koji bilo da pripadaju vladajućoj koaliciji ili su u nekim interesnim vezama sa njima, tako da ne mogu imati upliva u donošenju ovih važnih odluka. Ako je u pitanju bord koji je predložen, onda je osnovna primedba ta da bord treba sadržati predstavnike u svom članstvu svih zajednica. Do sada je bilo, u nekim slučajevima, primjera, dobrih primjera pa su imenovani predstavnici drugih zajednica, međutim u ovom slučaju to nije uradjeno.

Drugi razlog o kome govorim, jeste da su pojedini subjekti potpuno izostavljeni vezano za razgovore po ovim pitanjima, tako da nemar, neodgovornost bilo vladinih predstavnika, bilo Predsedništva ili ljudi koji se bave ovim pitanjima ili vodjenja ovog

pitanja samo nekoliko ljudi. Inače, to je u stvari možda i suština ovog i svih važnih pitanja koje donose milionske dobiti Kosovu. Kad god su u pitanju problemi koji su vezani za milionske dobiti, onda se uglavnom radi o odlučivanju vrlo malog broja ljudi, bilo da je to mali broj ljudi unutar Vlade, ili je to mali broj ljudi unutar Parlamenta, ili samo nekoliko ljudi u Predsedništvu i nekoliko šefova grupa, poslanici bilo da su u velikim grupama ili u malim subjektima su jednostavno izostavljeni, ignorisani i ne konsultovani. Ja apelujem da se ova ružna navika izostavi i da sve zajednice, svi politički subjekti, i veliki i mali uzmu učešća po pitanjima koja su od opšteg nacionalnog značaja i od značaja za sve zajednice i za sve građane Kosova. Hvala vam ljepa!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli, shef i Grupit të LDD-së, le të përgatitet deputeti Zef Morina.

LULZIM ZENELI: Ndoshta pas krejt këtyre argumenteve që i dhanë parafolësit që e kundërshtojnë fuqishëm vendimin e kësaj qeverie të bazuar në Ligjin për telekomunikacion, unë besoj se edhe interesimi i deputetëve po e them që kanë një qasje pak më ndryshe, ka qenë mbi bazën e asaj që sot do të dëgjojmë qoftë nga koalicioni qeverisës, qoftë nga Qeveria, argumente pse ky vendim është në përputhje me ligjin. Ajo që ka ndodhur në Komisionin parlamentar për Ekonomi, Telekomunikacion e tjera, e tjera fushëveprimet që i ka, nuk mund të quhen ndryshe përpos korrupsion politik. Në qoftë se një komision parlamentar merr një qëndrim të tillë apo i procedon Kuvendit një vendim i cili është në kundërshtim të plotë me ligjin, atëherë si mund të quhet ndryshe. Ky vendim në qoftë se kalon sot përmes këtij Kuvendi, atëherë ky është jo vetëm komision parlamentar i cili nuk mund të quhet ndryshe pos se është i korruptuar politikisht me këtë rast, por edhe Kuvendi i Kosovës vendoset në lajthitje. Prandaj, kërkojmë që Kuvendi i Kosovës sot ta ndërpresë një praktikë, praktikë e cila ka qenë shkelje flagrante e ligjeve përmes vendimeve të cilat i kanë aprovuar nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Po e them dhe përsëris, pika 6, neni 6 pika 5 në mënyrë flagrante bie në kundërshtim me vendimin e kësaj qeverie. Neni 7 pika 3 mbi kualifikimet edhe të këtyre anëtarëve që janë propozuar sot. Kualifikimet qartë janë precizuar se cilat kualifikime duhet t'i posedojë një anëtar i bordit. Nuk ka nevojë këtu inxhinierë të makinerisë ose dikush tjetër. Janë fusha, dihet, sektorë të telekomunikacionit, jurisprudencës dhe ekonomisë dhe janë qartë të precizuara me ligj, ndërsa këtu kemi edhe të natyrave dhe profileve tjera.

Prandaj, ne, jo vetëm si Grup Parlamentar, por tash edhe si deputetë, bëjmë thirrje që të mos tolerojmë shkelje të tillë dhe mos të tolerojmë të vazhdojë një praktikë e tillë e cila jo vetëm që është shkelje flagrante, por edhe po e dëmton dhe po e devalvon dhe lirisht këtu mund ta quajmë edhe komprometim të punës së Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën për të replikuar në emër të komisionit... edhe pse nuk ju është përmendur emri, por komisioni.

MUZEJENE SELMANI: Në bazë të votimeve brenda komisionit, pa të keqe, nuk mund të quhet komisioni i korruptuar ose komision i korruptuar politik për arsye se të gjitha grupet parlamentare kanë deputetë brenda këtij komisioni dhe më vjen shumë keq që duhet thënë sot këtu që përfaqësuesi nga grupi yt parlamentar e ka votuar në mënyrë të plotë këtë propozim, ndërsa ne tjerët, ka pas edhe... Jo, ju kërkoj ndjesë. E keni pasur deputetin në atë grup parlamentar dhe e ka votuar, pa të keqe, se është transkripti, mund

t'i marrim të gjitha të dhënat prej komisionit, nuk mund të quhet komisioni si komision i korruptuar, ju lutem. Që lista është ardhur me emra që e kanë shkel ligjin, është më se e vërtetë. U krye.

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me diskutues të radhës. Fjalën e ka deputeti Zef Morina, le të përgatitet deputeti Gani Buçinca dhe deputeti i fundit, Riza Smaka. Po s'ë ke shkruar, ku është letra, me letra po e kërkon fjalën. Po, atëherë edhe Sala Berisha.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Vërtet, unë po çuditem si po i lexoni këto ligje, si po i interpretoni këto ligje, secili për qejf të vetin japin numra, japin shifra dhe asgjë nuk thonë. Është shumë e vërtetë se Bordi i ART-së nuk ka funksionuar si është dashur të funksionojë sipas ligjit. Kjo është e vërtetë, të gjithë pajtohemi me këtë. Është shumë e vërtetë që u bënë 9 muaj që s'kemi bord. Edhe kjo është e vërtetë. Është e vërtetë që Autoriteti Rregullativ ose Bordi e ka konsideruar veten mbi qeverinë. Edhe kjo është e vërtetë. Këto janë çështje që ... tash nuk po debatojmë për këtë. Tani po miratojmë një bord, i cili shpresoj se do të punojë si duhet, sipas ligjit. Ajo që mua po më shqetëson më shumë është që ligji e cakton shumë qartë kush e emëron bordin: ministria, ministri, Qeveria, Parlamenti. Komisioni s'ka punë me këtë. Ne e kemi diskutuar edhe në komision, kështu që s'ka të drejtë askush të thotë që komisioni... ose i korruptuar ose... Unë personalisht kam thënë, ne nuk kemi asnjë pikë obligim këtë bord ta përcjellim. E përcjell Qeveria në Parlament. E njëjta gjë është bërë... Po të lutem, lexoje ligjin.

Çështja tjetër. Nuk është obligative të jenë 2 vet të bordit të kaluar. Nëse s'do të jetë ai, domethënë duhet të mbetemi pa bord ne, a po. Të lutem, ligji nuk e obligon, është e drejtë, në qoftë se bordi ka funksionuar mirë, të jenë së paku 2 prej bordit të vjetër në këtë listë. Kjo është e vërteta. Pse nuk është, është çështje tjetër. Ne na ka ardhur, ju lutem... Unë, vetëm pak. Unë e thash edhe më parë...

KRYESUESI: Mundësisht, qetësi!

ZEF MORINA: Këta anëtarë të bordit, ish anëtarët e bordit unë i kam pru në këtë Parlament dhe po më duket bash në këtë sallë janë aprovuar dhe po aprovohen prapë, para 5 vite a 6, sa u bënë. Ishalla tash bëhen mirë... Ajo që është me rëndësi, është që të gjithë anëtarët e bordit, unë e kam përcjell situatën edhe pse kam qenë, do me thënë e kam kryer mandatin tim si ministër. Është shumë e vërtetë se nuk kanë funksionuar si duhet, por në mes tyre s'kanë qenë të gjithë që s'kanë punuar mirë. Edhe Qeveria e ka pa të arsyeshme që zoti Kurtaj, është shumë e vërtetë se ka qenë më i thirrur prej të gjithëve dhe ai meriton të jetë në listë. Këta të tjerët ndoshta edhe nuk kanë dëshirë dhe thjeshtë s'ë kanë merituar. Nuk e kanë merituar.

Ju lutem, ajo që është, kryetari i komisionit... Ti Driton, duke folur përditë këtu edhe kush nuk të përzihet, të lutem, ka që flasin më rrallë....

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, ta dëgjojmë njëri-tjetrin.

ZEF MORINA: Të lutem, pastroje fjalorin, sepse nuk po spekuloj por po flas drejt. Ti po flet përmendsh, se këtë unë e di ma mirë se ti. Okej, të lutem. A ka qenë a s'ka në komision, është tjetër, ne nuk po hymë aty, dikush tjetër merret me atë.

(Ndërhyrje e Driton Talit, nuk dëgjohej për transkriptim)

KRYESUESI: Zoti deputet, e keni konsumuar të drejtën e fjalës, të lutem!

ZEF MORINA: Unë mendoj që është shumë më e drejtë, më obligative për ne të shikojmë vërtet a është përcjell sipas ligjit. Unë po them sinjerisht që çdo gjë ka shkuar sipas ligjit, me përjashtim të materialit që na ka ardhur në Komision. Komisioni s'ka obligim ta miratojë ose mohojë, ose mos ta miratojë. Ne kemi thënë, procedoni ashtu si ka kërkuar Qeveria dhe kjo ka shkuar. Andaj, anëtarët e Bordit të cilët tani janë këtu, unë mendoj se të gjithë i plotësojnë kriteret. Nëse ka konflikt interesi, merret dikush tjetër me këtë çështje. Po flas edhe si deputet, por ju lutem... Ju lutem! Disa herë e kemi akuzuar, jo akuzuar por e kemi kritikuar bordin, por asnjëri nga ju, do s'keni qenë, nuk e keni ngritur zërin. Tani, pasi ka shkuar bordi, po bërtitni. Kjo s'është në rregull, absolut. Unë mendoj se bordi është në rregull dhe çdo gjë është në rregull.

KRYESUESI: Faleminderit! Një minutë, replikë Driton Tali se ia përmendët emrin, zoti Morina.

DRITON TALI: Unë nuk di qysh t'i them ndryshe këtij përpos spekulim, tash kujt s'i pëlqen kjo fjalë, le ta marrë fjalorin e të sheh çka do me thënë spekulim. Nëse Lulzim Kurtaj ka qenë personi përgjegjës për 16.2 milionëshin dhe ai 16.2 garancion është humbur... Unë e kam parasysh që ish ministri është milioner, 16 milionë s'i çojnë peshë, por për qytetarin e rëndomtë të Kosovës 16.2 milionë janë pare të mëdha. Kjo ishte... Dhe është propozuar përsëri. Pastaj, Lulzim Kurtaj e ka shkelur ligjin edhe te Operatori i dytë, sepse ka qenë edhe anëtar i komisionit dhe pastaj në Bord ku kanë marrë pjesë veç 3 vetë ka votuar, që s'ka pasur të drejtë, sepse s'ke të drejtë të jesh edhe në komision për të njëjtën çështje dy herë të merresh, e të tjera, e të tjera. Nëse këto shkelje janë të vogla..... sinjerisht po dyshoj se e paskeni udhëhequr një ministri....

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë! Replikë, ish ministri!

(Ndërprerje e shkurtër)

ZEF MORINA: Kolegë, nuk jemi kolegë me profesion por që jemi deputetë, po, sigurisht. Ndoshta unë kur kam punuar ti j e kanë në shkollë fillore hala, e kur i kam bërë milionat, atëherë ndoshta edhe....

Desha një gjë... Jo, jo s'ka lidhje. Jo s'janë pak, ndoshta edhe 100 janë pak, por desha një gjë të ta them. Sa jam unë në dijeni, Lulzim Kurtaj s'ka pasur të bëjë me fletë-garancionin... Të lutem, ajo është çështje e dikujt tjetër, mos i ngatërroni gjërat për ta hutuar opinionin. Ju lutem, gjërat mos i përcillni këtu ato që nuk janë në rregull. Ne po flasim për anëtarët e bordit. Mund të votosh "kundër", mund të votosh "për". Për mua s'ka rëndësi. Unë vetëm desha ta them një gjë se jeni duke lexuar ligjin mbrapsht dhe dilni bërtitni këtu duke e lexuar mbrapsht.

KRYESUESI: Vazhdojmë! Jo, zoti Tali, të lutem! Nuk e keni fjalën, zoti Tali, dhe vazhdojmë.

DRITON TALI: Po, se në kundër replikë ma përmendi emrin. Veç desha të them, nëse kryetari i komisionit nuk është përgjegjës, shpjegomani ju lutem se kush është përgjegjës.

KRYESUESI: Zoti Tali, të lutem, po vazhdojmë. Diskutuesi i radhës është Gani Buçinca. Mos ia përmend emrin!

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë, ju përshëndes të gjithëve. Më paska pas marrë malli t'ju shoh! Dhe e shfrytëzoja rastin të flas këtu jo për çështje profesionale, por për disa çështje parimore. Ekziston këtu një paradoks në mes asaj çka flet opozita dhe individë të caktuar të pozitës. Jo, s'ka me emra, të cilët, të shtyrë qoftë prej nevojave partiake, qoftë prej ambicieve personale, ambicieve personale të parealizuar, për fat të keq, të parealizuar për fat të keq të tyre, e për fatin e mirë të Kosovës, bëjnë këtu shantazhe politike. Këtu dikush e përmendi fjalën spekulim, po kjo është një formë shantazhi për arsye se kemi hyrë në fushatë, në parafushatë jemi dhe shfrytëzohet, gjë që unë e kuptoj si krejt normale. Krejt normale, në politikë jemi dhe nuk ka asgjë të keqe këtu, që dikush mundohet të përfitojë nga kjo pikë e rendit të ditës.

Ku ishin çështjet parimore për të cilat desha të flas unë këtu. Në këtë Kuvend jo, po në atë Kuvendin tjetër, në atë sallën tjetër, në atë lokacionin tjetër, kemi dëgjuar shpeshherë pse s'po konstituohet bordi i ART-së.

KRYESUESI: Zoti, deputet, mundësisht në temë...

GANI BUÇINCA: Urdhëro! Po, në temë unë jam duke folur, pikërisht dhe jam shumë në temë. Pse s'po konstituohet Bordi i ART-së dhe kemi vonesa në konstituimin e bordit. Tash, kur do Qeveria të konstitujë bordin, dalin probleme tjera. Dhe, shih çfarë problemesh dalin! Disa thonë se të gjithë ata që kanë punuar në atë bord duhet të ndiqen penalisht për shkeljet që i kanë bërë në të kaluarën, kurse në anën tjetër thonë shkelet ligji pse nuk janë dy anëtarë të atij bordi në bordin të cilin e propozon Qeveria. Do me thënë, këtu është paradoksi juaj dhe këtu shihet josinqeriteti i juaj.

Tjetër, ku është problemi edhe më i madh. Thotë, ta formojmë një komision hetimor, ta hetojmë ART-në për një periudhë 6 vjeçare a 7 vjeçare mbrapa dhe pastaj ne të propozojmë t'i japim leje Qeverisë të propozojë anëtar të ri të bordit pasi që ne ta konstatojmë gjendjen çfarë ka qenë në të kaluarën aty.

Këto gjëra, kolegë të nderuar, nuk shiten dhe nuk përfitoni dot politikisht duke qenë kaq jo konsistent në parimet dhe në motivet për të cilat ju e kontestoni bordin e propozuar, kështu që unë ju kisha lutur që ta votojmë bordin, pastaj komisioni hetimor le të jep iniciativa në komision, këtu në Parlament, le të bëhet komisioni hetimor, le t'i konstatojë gjërat ashtu siç kanë qenë, le ta denoncojë në prokurori dhe kështu punohet, kurse për ndryshe, ne për çdo pikë të rendit të ditës do të mbesim duke bërë propagandë, propagandë e cila e ka një shije të imoralitetit politik dhe kjo më së shumti më pengon, se nuk ka argumente absurde... Një dokument këtu thotë, neni 6 shkelet, po bëjnë shkelje flagrante, kërkojmë UNMIK-un, kërkojmë... edhe gjithë botën të ndërhyjë këtu, kurse nuk tregon çka po shkelet neni 6. Neni 6 po shkelet vetëm për një arsye – pse nuk është në bordin e propozuar edhe një anëtar nga bordi që sipas opozitës paska dështuar. Dhe unë plotësisht pajtohem me atë çka tha kolegu Zef Morina se, sipas jush, ne nuk do të duhej të merrnim asnjë anëtar të atij bordi dhe nuk kemi kompetenca ne të hetojmë cilat

kanë qenë rrethanat objektive në të cilat Qeveria e ka marrë këtë vendim. Mund t'i hetojmë ato më vonë, mirëpo sot ta votojmë bordin dhe të ecim përpara. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Nuk ta ka përmendur emrin!

NASER RUGOVA: Më falni! Unë nuk i kam replikuar askujt deri sot në këtë Kuvend, por zoti Buçinca po të drejtohem direkt: Neni 6 dhe alineja 5 janë të Ligjit për telekomunikacionin, që e ka shkel shefi yt, Kryeministri i vendit, kryetari i partisë tënde.

Më fal, unë fola në kuptimin procedural dhe si deputet dhe nuk desha të lëshohem në këto gjëra.

Pastaj, moralitet e imoralitet politik..., ju lutem, ne jemi kolegë këtu dhe duhet ta ruajmë kulturën edhe të të shprehurit dhe pozicionin e të zgjedhurit të popullit.

Ata që e shkelin ligjin, nuk përmenda UNMIK, me UNMIK po merreni ju, me protokolle, me 6 pikësha, me Rezolutë 1244, kurse unë i bëra thirrje shefit të ICO, zotit Piter Feit, që të ndërhyjë e të mos shkeljet ligji në mënyrë flagrante. Ju lutem, dhe nuk di pse po çoheni kundër atyre që po donë ta mbrojnë ligjshmërinë dhe ligjshmëri. Dhe nëse ky vendim ecë tutje, atëherë ne kemi për ta shqyrtuar, do të thotë, pozicionin tonë a të marrim pjesë në këtë Kuvend me këtë logjikë, sepse vërtet ky Kuvend e ka humb kuptimin e të qenit dhe të veprimit të punës së tij.

Zoti kryesues, do të thotë, njerëzit që dalin jashtë temës për të cilën po bisedojmë dhe që nganjëherë fyejnë kolegët me dashje apo pa dashje... Unë s'kam dalë të të fyej, zoti Buçinca. Kam dalë të të replikoj, sepse e ceke nenin 6 që e thashë unë. Realisht ka shkelje ligjore. Ligji po shkelet me vetëdije prej partnerëve të koalicionit dhe ju bëftë mirë! Nuk ka këtu çka tjetër.

KRYESUESI: Të nderuar kolegë, jemi në... Veç pak, zoti Buçinca, mund ta merrësh fjalën edhe për replikë, sepse t'u përmend emri, sigurisht. Unë dua të tërheq vërejtjen se ne po diskutojmë për një propozim të komisionit dhe sigurisht debati është i lejuar, por jemi në fazën që komisioni, ku kemi pasur përfaqësues të gjithë, i ka rekomanduar seancës, Kryesia ka kërkuar nga komisioni që të japë rekomandime dhe e ka dërguar në komision këtë. Pastaj, komisioni e ka bërë punën e vet dhe e kemi përpara materialin. Është mirë që në njëfarë mënyre të jemi racional në funksion të propozimit të komisionit dhe të kursehem nga, si të them, debatet individuale ose replikat individuale, sepse kjo na çon në një debat të pafund dhe në një epilog që s'mund të jetë pozitiv. Zoti Buçinca..., një minutë e keni, zotëri!

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryetar!

Nuk dola të replikoj as ta tensionoj situatën. Spekulimi, konspiracioni, teoria e konspiracionit dhe spekulimi janë mjete politike. E vërtetë, dhe ju keni të drejtë t'i përdorni ato. Mirëpo, unë nuk kam faj duhet t'ju tregoj se këto janë mjete imorale të politikës dhe morali politik krijohet mbi bazën e parimeve të qarta politike. Në rast se ju doni të leni Kosovën pa bord, aktualisht, ju nuk do të arrini sot, sepse s'i keni numrat, se edhe ligjin e bëjnë numrat, kështu që....

(Ndërprerje e diskutimit)

KRYESUESI: Vazhdojmë me diskutuesit e radhës. Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet deputetja Sala Berisha.

RIZA SMAKA: I nderuari kryesues, deputetë të nderuar,
Nuk është hera e parë që Kuvendi i Republikës së Kosovës me apo pa dashje e shkel, nisur nga Kushtetuta e më pastaj në hierarki deri te aktet nënligjore, ligje e kështu me radhë. Ka shumë raste. Ose, nuk është rasti i parë që flitet keq e më keq, zi e më zi për institucionet e caktuara, në këtë rast për këtë Bordin e Autoritetit të Telekomunikacionit, që u fol kështu konkretisht apo jo, për abuzime, ju lutem, për keqpërdorime, për përvetësime ilegale, e tjera e tjera dhe po thuaj se së paku deri më sot kemi aplikuar këtë metodologji. Ose, ta marr si shembull Radiotelevizionin e Kosovës, që varg e vi të gjithë deputetët, pa marrë parasysh përkatësitë në subjektet politike, kanë folur ashtu si është dashur të thuhet dhe merr fund. Çka ka qenë kërkesa elementare, që të ngrihet komision parlamentar dhe nuk është ngritur. Pothuaj se është bërë tabu temë ngritja e komisionit parlamentar. Në parlamentet tjera të shteteve moderne për çështje krejt të imëta ngrihet komisioni, hulumton, e bën raportin, e jep, zhvillohet debati për të, bihet konkluzion apo vendim. Ju lutem, ose te ne pothuaj se nuk ekziston përgjegjësia politike fare. Vetëm një shembull, kurrë s'e harroj, vice-presidenti i SHBA-ve Spiro Agnew për 5 dollarë, ju lutem kolege, kinse evazion tatimor, ka dhënë dorëheqje. Kjo te ne, pothuaj se nuk ekziston.

Unë, angazhohem, zotëri kryesues, kolegë të nderuar, që ta ngrehim një komision parlamentar hetimor. Në qoftë se këta persona që janë propozuar dhe komisioni që ka qenë në përbërje të gjerë nga partitë politike pozitare dhe opozitare ka konkluduar se i plotësojnë kushtet, unë asgjë nuk kam kundër, le të formohet ky bord, por se me detyrë që edhe ky bord menjëherë le t'i bëjë investigimet e programuara, jo kështu ad-hoc apo jo, për keqbërjet, malverzimet dhe spekulimet e thëna dhe të pathëna, që dihen dhe që nuk dihen, së paku jo kështu apo jo, ama të ngrihet komisioni parlamentar hetimor dhe t'i caktohet termini që brenda, po e zëmë, një muaj ose eventualisht dy muajve, të japë raportin dhe ta diskutojmë. Ju lutem, angazhohem përfundimisht që ne germën e Kushtetutës e pastaj natyrisht ... që t'i përfillim...

KRYESUESI: Zoti, Smaka, në temë mundësisht...!

RIZA SMAKA: Ju lutem, zoti kryesues, unë për temë po flas. Unë jam shumë i interesuar për aplikimin e Kushtetutës. Kur e them këtë, është fjala për rendin juridik, për ligjet dhe nuk mund të bëhet ndryshe. Pra, ju lutem, propozoj të formojmë komisionin parlamentar hetimor. Kaq.

KRYESUESI: Faleminderit! Ju kujtoj se po bisedojmë për Propozim-vendimin e Qeverisë që ka kaluar edhe nëpër komisionin përkatës dhe tash po e diskutojmë për të ardhur deri te faza e votimit apo mos votimit të tij. Kisha lutur të gjithë kolegët deputetë që të përmbahen, të flasin, e kanë marrë materialin, mund të flasin edhe për emrat, sepse ata janë këtu për të dhënë mendimin ne për ta, po jo për dukurinë, dukurinë në ART të cilën nuk mund ta zgjidhim sot.

Vazhdojmë. Diskutuesi i radhës është Sala Berisha, le të përgatitet Bahri Hyseni.

SALA BERISHA: Faleminderit, zoti kryesues!
Përshëndetje të gjithë ju kolegë deputetë,

Së pari, uroj një fillim të mbarë të këtij sesiioni të Kuvendit të Kosovës, duke dëshiruar që të keni pushuar mirë dhe jeni mbushur me energji pozitive që këto energji pozitive të reflektojnë pastaj edhe në opinion.

Është edhe një ftesë e imja personale ndaj disa kolegëve të mi deputetë nga ana e opozitës: shfrytëzoni energjitë pozitive të reflektoni pozitivisht, mos i përdorni energjitë negative tani në këtë parafushatë se do të mbeteni gjatë në opozitë.

Këtu, edhe diçka...

KRYESUESI: Kolege, mundësisht për temën!

SALA BERISHA: Në temë do të përpiqem të jem, zoti kryesues. Këtu desha të përkujtoj, edhe pse sigurisht jam e parafundit, të përkujtoj se pikë e rendit të ditës është vendimi i Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të ART-së dhe desha t'i përmend edhe një herë emrat dhe ta bëj një përmirësim që i prezantoj kryetarja e komisionit. Për anëtarë të Bordit Qeveria i ka propozuar: Ekrem Hoxhën, Lulzim Kurtajn, Besnik Berishen, Naser Shalën dhe Nijazi Ademajn.

Sa u përket vërejtjeve që i kemi në Bordin e kaluar të ART-së, ne kemi pasur edhe një diskutim në Parlamentin e Kosovës, kur ka qenë raporti i ART-së. Tani jemi në votim ose në mos votim dhe është çështja e juaj se a do t'i votoni apo nuk do t'i votoni këta. Ky vendim i Qeverisë për Bordin e ART-së është konform ligjit në fuqi, edhe pse disa këtë foltore e përdorën për shkak të opinionit për ta dezinformuar opinionin publik, por vendimi vjen konform ligjit. Në ligj thuhet decidivisht se preferohet t'u vazhdohet së paku dy anëtarëve të bordit mandati në mënyrë që të ketë kontinuitet, po nuk thotë se obligohen gjithsesi ata, deshën apo nuk deshën t'ju vazhdohet mandati.

Mandej, këtu është një mendim kontraverz nga ana e disa deputetëve që thonë se ai bordi i kaluar, puna e tij kërkon një komision hetimor dhe nga ana tjetër propozojnë që t'u vazhdohet disa prej tyre mandati, prandaj as vetë nuk e kanë të qartë se çka po duan dhe çka po kërkojnë.

Nuk ekziston asnjë arsye për të mos u votua ky bord, sepse duke i pasur parasysh vërejtjet që i cekët edhe ju, e që kemi edhe ne vërejtje në bordin e kaluar, nuk mund ta marrin fajësinë këta të propozuarit tani këtu, prandaj unë e shoh një logjikë negative nga ana juaj që bëni thirrje të mos votohet ky bord për shkak se ai bord ka pasur shumë gabime.

Kërkoj që të hidhet në votim ky propozim i Qeverisë dhe ju ftoj që ta votoni bordin që e ka propozuar Qeveria e Kosovës, në mënyrë që para se gjithash ne si deputetë dhe si parlament t'i përmbushim obligimet tona ligjore dhe obligimet për të cilat na ka votuar qytetari i Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, le të përgatitet deputeti Fatmir Rexhepi. Janë edhe tre diskutues pas këtyre që i thashë.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Jo, është mirë ndoshta të sqarohen do çështje që po i ngrehim. Së pari, është një propozim i komisionit funksional. Propozim, i cili, po të mos kishte marrë vota të duhura, s'kishte

ardhur si propozim dhe, natyrisht, Qeveria ishte dashur të bënte propozim tjetër. E kemi një komision funksional, i cili ka propozuar të aprovohet ky bord.

Çështja e dytë është – a mund të deklarojë dikush që ky bord është funksional. Absolut, jo. Për dhjetë muaj nuk funksionon.

Çështja tjetër. Për një bord i cili nuk funksionon për dhjetë muaj, për një bord i cili kurrë nuk ka përgatitur raport para këtij Kuvendi, për një bord për të cilin me plotë përgjegjësi, edhe unë po them si deputet, bëni një nismë dhe unë do të nënshkruaj që të formohet një komision hetimor, por pritni pak se po e bëjmë ligjin për hetim parlamentar, do të nënshkruaj i pari dhe ta shikojmë komplet punën e bordit, sot mos të dalim me zëra që të mos e formojmë një bord tjetër. Bordi duhet të formohet, sepse është çështje që pa e formuar bordin ne nuk krijojmë asnjë mundësi të shohim se si është menaxhuar, si janë marrë vendimet, çfarë vendimesh janë marrë dhe a janë vendime në interes të Kosovës.

Për të gjitha këto që i përmendët, pajtohem dhe unë mendoj si deputet, do të jem i pari që do të nënshkruaj, qoftë si deputet, qoftë si komision për të marrë pjesë në hetimin e punës së bordit të kaluar.

Mirëpo, mos t'i lexojmë ligjet si po na konvenojnë për situata. Asnjë deputet unë mendoj nuk është interesuar ta shkel ligjin, edhe unë personalisht, jo. Unë personalisht po flas, nuk jam i interesuar ta shkel ligjin dhe dini që shumë propozime të Qeverisë nga 7-8 herë i kemi diskutuar në komision mu pikërisht për ligjin, për të mos e shkelur ligjin. Mirëpo, mos ta lexojmë... Pjesa ku thotë që të ruhet kontinuiteti, nuk është pjesë normative. Ta dallojmë atë pjesën normative. Po të thuhej në ligj, nuk formohet bordi nëse nuk i ka së paku 2 anëtarë të mandatit të kaluar, është pjesë normative. Mirëpo, ligji thotë – do të ishte me interes të ruhet kontinuiteti për 2 anëtarë, natyrisht nëse kanë pasur sukses dhe nëse puna e bordit është vlerësuar pozitivisht. Të gjithë qytetarët dhe deputetët konsiderojnë se puna e bordit ka qenë e keqe, jo në interes të qytetarëve dhe pse të ruhet kontinuiteti. Ndoshta është ruajtur me një anëtar dhe është mirë që është ruajtur me një anëtar për të pasur mundësi të shihet dhe ndoshta të sqarohet situata se si ka shkuar situata për këta muaj të tërë që dikush s'ka raportuar.

Prandaj, unë konsideroj që komisioni ka pasur të drejtë të rekomandojë, Qeverisë i jepet autoritet në bazë të ligjit në fuqi t'i propozojë njerëzit që e kanë përgatitjen profesionale dhe kërkoj që ky Kuvend ta votojë bordin dhe bordit t'i japë mundësi që menjëherë të marrë masat për t'i sjellë një raport këtij Kuvendi dhe të hetohet puna e bordit të kaluar dhe të gjitha procedurat dhe vendimet që i ka marrë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, le të përgatitet deputeti Ramadan Avdiu.

FATMIR REXHEPI: Unë po e shfrytëzoj rastin edhe për kryetarin e Parlamentit, edhe për kryesuesin, të prezantohem edhe një herë që jam Fatmir Rexhepi, deputet i Lidhjes Demokratike këtu në Parlament të Republikës, mos ta harrojnë fort emrin, pra.

Arsyeja e parë që dola është thjeshtë kjo që më bëri përshtypje pak debati dhe të shpreh reagimin tim si një anëtar i komisionit parlamentar. Mendoj se të gjithë kolegët deputetë janë kredibël në mandatin e vet politik që të procedojnë dhe të japin propozime në pajtim me detyrën që e kanë. Mirëpo, këtu në foltore dëgjova pak më herët se ky komision është

i korruptuar politikisht dhe të tjera, prandaj unë kërkoj nga deputeti Zeneli që ta tërheq, ta përmirësojë pak këtë dhe t'i përmbahet një kodi tjetër parlamentar. Është i ri të na ngarkojë me atë barrë, nuk e mbajmë fort...

Tjetra, çështja e dytë, është se të gjithë e dimë që ky është propozim i Qeverisë, procedohet në komision, komisioni e ka shqyrtuar, i ka bërë rekomandime këtij parlamenti dhe unë nuk e di pse kaq dramë po e bëjmë këtë relacion në mes asaj se a është ligjore a s'është ligjore. Prandaj, nuk është korrekte as kjo dhe unë mendoj që debatet nuk na kanë munguar ne edhe më herët sa i përket ART-së, se cili ka qenë interesi i kësaj fushe të telekomunikacionit dhe shumë çështje të tjera, prandaj unë mendoj se komisioni nuk ka bërë ndonjë punë të madhe, pos që e ka proceduar, ka rekomanduar dhe tash i mbetet Parlamentit sot, varësisht nga debati dhe varësisht nga vlerësimi që e ka, deputetët të votojnë ose të mos votojnë.

Prandaj, unë jam për atë që të votohet sot bordi, sepse vërtet është me interes të veçantë dhe të kryejnë punë njerëzit për detyrat që i marrin. Dhe, kur jemi te kuadrot që këtu i kemi në listë, u përmendën njerëzit, kuadrot pa të drejtë dhe në mënyrë të themi jo etike për arsye se këta njerëz që janë propozuar këtu, bile disa, ata që i njoh unë, e në këtë rast u përmend edhe zoti Ekrem Hoxha, unë mendoj që nuk kemi të drejtë në këtë foltore të dalim dhe të japim kualifikime të ndryshme. Njerëzit kanë të drejtë të punojnë në kompani qoftë vendore, qoftë ndërkombëtare, të jenë njerëz specialistë, menaxherë të mirë dhe të tjera, prandaj paragjykimet në këtë formë nuk janë të mira. Sepse mendoj që janë të dëmshme edhe për deputetin, në radhë të parë, por edhe për neve si Parlament. Prandaj, unë mendoj që të lexohet më mirë edhe CV-ia e kuadrove, njerëzve që janë këtu, që tregon se vërtet janë njerëz specialistë, kuadro të mira, që kanë një kredibilitet dhe është mirë t'i votojmë. Prandaj, i lus ata deputetë që të mos nxjerrin këtu emra për të cilët vërtet nuk qëndrojnë kualifikimet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lulzim Zeneli, replikë një minutë.

LULZIM ZENELI: Për të gjithë ata deputetë të cilët janë përfaqësues të popullit, për çdo komision parlamentar i cili e shqyrton një lëndë dhe një vendim të Qeverisë dhe i mbyllë sytë para ligjit, nuk mund të quhet ndryshe përpos korrupsion politik. Është forma më e butë që mund të shprehet në Kuvendin e Kosovës.

Nëse jemi përfaqësues të popullit dhe jemi të autorizuar ta mbrojmë interesin e qytetarit përmes respektimit të ligjit, atëherë unë nuk di për çka mund të bëhet fjalë sot këtu ndryshe.

Nëse thuhet për kuadrat të cilat janë propozuar këtu, edhe nëse anashkalohet, i mbyllim sytë para nenit 6 të pikës 5, neni 7 pika 3 e specifikon qartë se cilët kuadro mund të propozohen për anëtarë të bordit. Ja shikoni, rasti konkret. Të dhënat e Nijazi...

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Ju ka skaduar koha! Zoti Tali thotë se në mënyrë kontekstuale është....

DRITON TALI: Zoti Fatmir Rexhepi, me gjithë respektin që kam ndaj teje, unë informatat që i kam është se Ekrem Hoxhaj ka qenë ... i Devollit. Madje është propozuar edhe për drejtor apo menaxher i Dardafonit. Devolli është aksionari kryesor i Dardafonit.

ART merret pikërisht me këto punë dhe kjo është konflikt i interesit. Është çështje e Ekrem Hoxhës ta pastrojë veten. Unë po them edhe një herë, detyrë e imja, si përfaqësues i qytetarëve të Kosovës është ta hap këtë temë këtu, e tij është për me dal... janë edhe dokumentet të cilët e akuzojnë për një çështje të tillë, nuk është e imja, nuk jam avokat i tij.

KRYESUESI: Faleminderit! Ju ka skaduar koha, zoti Tali. Zoti Tali, mund ta thoni edhe tjetër kund, ju ka skaduar koha. Fjalën e ka deputeti Ramadan Avdiu, le të përgatitet deputeti Hajdin Abazi. Ju lutem, mos përmendni emra se po zgjatemi shumë pastaj.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Shpresoj se zoti Tali dhe kolegët tjerë deputetë do të kenë durimin që të më dëgjojnë. Nuk e kisha ndërmend të debatoj, të diskutoj, sepse esenca e asaj çka pata plan të them, u tha nga disa kolegë paraprak. Është bërë një praktikë e keqe nga disa kolegë deputetë, që nuk dëshiroj ta shoh Kuvendin në gjendje të tillë, kur nuk dëshirojnë të procedojnë diçka, thonë ka shkelje ligji.

Para disa seancash është debatuar për ART-në. Ka qenë thuar një mendim uniform, një mendim i gjithë Kuvendit që bordi ekzistues nuk është funksional, Bordi ekzistues nuk e ka kryer punën si duhet. Për këtë janë pajtuar të gjithë deputetët, prandaj edhe Qeveria ka vepruar dhe e ka kryer punën e saj. Ajo i ka dërguar propozimet konform ligjit, i ka dërguar propozimet konform ligjit, të cilat propozime janë shqyrtuar edhe në komision dhe komisioni e ka dërguar rekomandimin. Pra, Qeveria e ka kryer punën e saj, komisioni e ka kryer punën e tij, mbetet që edhe Kuvendi ta kryej punën e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Hajdin Abazi, le të përgatitet deputeti Gani Geci dhe i fundit Armend Zemaj, e potencoj, i fundit.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Jemi tash duke diskutuar për zgjedhjen e Bordit të ART-së dhe tash një fenomen i tillë po na shfaqet shpesh. Kur ofrohet një zgjidhje befas, një pjesë e kolegëve që janë më të zëshmit për të gjetur zgjidhje, kur ofrohet një zgjidhje tash kthehen dhe duan ta pengojnë një zgjidhje. Nga të gjithë këto, të lutem Driton, dëgjo nga vendi, kur ta mbaroj mund të dalësh, sepse nuk është e kulturuar kështu. S'i kam folur askujt, le të dëgjohe mi, pastaj flasim.

Kështu, çështja është do të thotë që kërkohet zgjidhje, kur ofrohet zgjidhja refuzohet. Tani çka po duam ne? Këtu ashikare po shihet se çdo propozim, çdo zgjidhje që dëshirohet të bëhet duhet të pengohet. Unë të gjithë ata i dëgjova pa dallim duke folur në mënyrë kritike për bordin aktual që është ose që nuk funksionon. Dhe, çka dëshirohet duke u refuzuar kjo, të vazhdohet e njëjta gjendje. Tjetër logjikë kjo nuk ka. Nëse nuk gjendet një zgjidhje, kolegë do të vazhdojë kjo gjendje kaotike dhe nesër kush do të akuzohet, do të akuzohet Qeveria që s'ka gjet zgjidhje, kurse Qeveria ofron zgjidhjen dhe këtu tash flitet mbarë e mbrapsht. Një çështje duhet ta kemi të qartë: shkarkimi i bordit të kaluar nuk është edhe lirim prej përgjegjësisë juridike ose penale nëse ndokush prej tyre e ka bërë, sepse veprat penale nuk vjetrohen, si të thuash, me shkuarjen prej bordit ai lirohet prej përgjegjësisë së shkeljeve ligjore të cilat kanë mund t'i bëjnë gjatë ushtrimit të punëve. Ky problem, mos e keni gajle, për këtë vetëm gjeni fakte, argumentoni dhe unë personalisht do të jam i pari që do të përkrah dhe do të mbështes këtë. Duke e hequr

këtë dilemë, atëherë mbetet dilema tjetër, a duhet ne të vazhdojmë me prolongime apo duhet të ofrojmë zgjidhje. Nëse ju kujtohet, kur kemi diskutuar edhe Strategjinë antikorruption që është ofruar, unë kam thënë se opozita ka qenë më e zëshmjë se po ka korrupsion, kur u ofrua një strategji të luftohet, opozita e kundërshtoi, për fat të keq, dhe çka ndodh tani, ende ne nuk e kemi një strategji që të luftohet korrupsioni. I njëjti asocim, e njëjta gjë, për fat të keq, tash këtu dëgjohet edhe nga çështja e bordit. Unë e kuptoj se ka ndokush për interesa të caktuara që nuk dëshiron të ketë zgjidhje. Personalisht asnjë prej kandidatëve të propozuar nuk i njoh, përpos CV-ve që i kam lexuar dhe përgatitjet e tyre. A ka shkelje ligjore? Këtu dëgjuam se shkelje ligjore nuk ka meqenëse ligji nuk e thotë në mënyrë decitive që patjetër duhet të jenë 2 vetë nga bordi i kaluar që të ruhet kontinuiteti. Ju lutem, vërtet ne jemi deputetë dhe të dalim me dinjitetin tonë si deputetë. Nëse ka gjëra që mund ta kundërshtojmë, le të argumentojmë për to, por jo vetëm të flasim sa për të kundërshtuar. Unë jam ithtar i asaj që të gjejmë zgjidhje dhe ta bëjmë funksional bordin e ART-së me qëllim që punët të vihen për së mbari dhe të mos e lejojmë një gjendje defektoze, një gjendje jo funksionale, një gjendje kundër të gjithëve që ne jemi. Prandaj, të nderuar kolegë, ata që duan zgjidhje, do të ishte mirë që të logjikojnë në mënyrë të shëndoshë dhe të mos shfrytëzohet vend e pa vend tribuna për fushatën para zgjedhore, se mund të kthehet edhe si bumerang. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për replikë, një minutë, është paraqitur Driton Tali.

DRITON TALI: Ma përmendët emrin. Unë, zoti Hajdini, jam shumë i kulturuar, për shkak të kulturës që kam dhe respektin e votuesit tim, po dal këtu të flas. Është problem i juaji, i koalicionit të panatyrshëm qeveritar që s'mund të më durojnë, është problem i juaji. Nuk jam anëtar i partisë tënde. Unë kam për obligim që qytetarit të Kosovës t'ia tërheq vërejtjen dhe ta mbrojë... Pikërisht për dy persona të cilët dyshohen: Lulzim Kurtaj, nuk është zgjidhje. Zgjidhje mund të jetë tjetër send. Qeveria nuk ka ardhur me zgjidhje. Lulzim Kurtajn nuk e njoh, kurrë në jetën time s'e kam parë, por ai është përgjegjës për 16.2 milionë të na qartësojë. Nëse, prapë po them, janë pak 16.2 milionë të garancionit të parave, është çështje tjetër.

KRYESUESI: Zoti Tali, e keni shpenzuar minutën për replikë dhe zgjidhja... Zoti Tali, mund të shkojmë në pauzë dhe pastaj vazhdojmë. Kemi edhe dy diskutues.

(Zhvillohet polemikë)

Shikoni, ju të dytë po flisni për zgjidhje dhe zgjidhja që mund të japim ne këtu është të votojmë ose të mos votojmë, jo zgjidhje tjera. Urdhëroni!

(Ndërprerje e incizimit)

HAJDIN ABAZI: Zoti Tali, tani po ta përmend drejtpërdrejt emrin. Unë fola vetëm pse po flet nga vendi, nuk është e dinjitetshme. E po, të lutem, e pate foltoren, të gjitha ato që pate për t'i thënë i the, ne i dëgjuam, kështu që unë në këtë aspekt fola dhe jo për diçka tjetër. Dhe replika bëhet në kontekstin për çka të përmendet emri, nëse është e kulturuar kur kolegu del e flet nga bina, të flasësh nga vendi, aty edhe ta bësh tollovi, atëherë është në rregull dhe varet prej çdo individi.

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me dy diskutuesit e fundit. Gani Geci e ka fjalën dhe Armend Zemaj, le të përgatitet i fundit. Njoftoj deputetët se është mbyll paraqitja për diskutim.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar, s'qenka askush këtu, por ata që janë,

Unë dëgjova kolegët e mi deputetë duke i thënë vërejtjet e tyre, por dëgjova edhe një fjalë që ne deputetët jemi fajtorë. Ndoshta edhe ne jemi fajtorë, sepse dikush prej deputetëve ndoshta i ka thënë dikujt që atij drejtorit të ART-së t'ia zë pritën atje kah shkon te mali dhe ta shpëtojë zoti për pak me të gjithë ata polic që i ka pasur. Dhe, ju lutem, ju lutem, nëse ne merremi me këso gjërash dhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës diskutojmë për këto gjëra, Kuvendit nuk i ka hije kjo. Nën një.

Nën dy, nëse ligjet e Republikës së Kosovës i kemi miratuar ne këtu në Kuvendin e Kosovës dhe ne i shkelim, qytetarët po na shohin dhe kjo është edhe më keq, por edhe nëse kemi bërë të këqija dhe kemi lënë hapësirë që të interpretohet ligji ashtu siç dua unë dhe ashtu siç dëshiron një deputet i pozitës, prapë ne jemi fajtorë, sepse ligjet duhet të bëhen të atilla që mos të mund të interpretohen në dy mënyra, por vetëm në një. Prandaj, në ligj ne kemi drejtë ta interpretojmë në mënyrën tonë, sepse është e shkruar kështu qysh është, që të ruhet kontinuiteti dhe të mbeten 2, ndërsa juve nuk ju konvenon dhe është e shkruar ashtu qysh po thoni ju, që të mbetet vetëm një sepse po ju konvenon juve të Qeverisë. Po ju konvenon kjo për një arsye, sepse tenderët e ri që kanë për t'u dhënë të telefonisë mobile, ju duhet shpejt e shpejt t'i kryeni dhe nëse s'i kryeni, s'keni para. S'keni para as për fushatë, prandaj është problem dhe këto duhet të rregullohen shumë shpejt. Nëse nuk rregullohen shpejt, do me thënë shkon koha dhe humbin paratë. Prandaj, nëse një drejtor i një bordi të ART-së që e kemi aprovuar ne ose e kanë aprovuar kolegët tanë që unë s'kam qenë atëherë deputetë, është në shtëpi për shkak se nuk guxon të shkojë në punë dhe këtu nuk është marrë asnjë hap që ai ose të zëvendësohet ose të vijë një tjetër, atëherë ai bord s'ka mund ta kryej punën si duhet. Është normale kjo punë, sepse nëse një drejtor mungon dy vjet në vendin e punës, çfarë pune kryhet aty.

(Ndërhyrje)

Po, ne tash s'po mundemi të tregojmë a është friguar, por realiteti është ky, ne po flasin për ART-në dhe për bordin e ART-së, për drejtorin e ART-së, jemi bash në temë.

KRYESUESI: Nuk ka replika prej vendit, kolege e nderuar!

GANI GECI: Prandaj, ju lutemi, nëse doni ta merrni fjalën, këtu si ta lëshoj unë, mund të vishë, por kur ta ndezi unë motorin, ndale ti, kur ta dali unë, ndize ti.

Ju lutem, ne nuk po dëshirojmë këtu të diskutojmë ashtu kuturu ashtu qysh po na teket, por po dëshirojmë të diskutojmë për drejtorin, për bordin e ART-së dhe ju keni propozuar një drejtor të ri apo një kryesues dhe e keni propozuar një bord, Qeveria e Republikës së Kosovës. Ne nuk jemi për ta lënë Bordin e ART-së pa drejtor, por ju që dy vjet e keni pasur pa drejtor, a nuk e keni dit këtë, a? Të gjithë e kemi ditur, jo vetëm ju dhe ju e keni ditur se kanë qenë kamerat, që Policia e Republikës së Kosovës e ka ruajtur drejtorin. A e keni dit këtë? S'e keni ditur asnjë a, që po ju tregoj unë. I kemi pa në televizor, do të thotë që e kanë ruajtur drejtorin dhe dy policë kanë shpëtuar fatmirësisht që atyre nuk iu

ka ndez një zolë që e ka goditur automjetin e drejtorit të Bordit të ART-së që ka qenë duke shkuar në shtëpi. Dhe shumë tjerë që kanë pësuar në këso raste, i dinë disa shokë të juaj dhe ju shumë mirë këto sende. Po ne s'po duam të hyjmë kësaj radhe në atë drejtim, por po duam të flasim për diçka tjetër. Po duam të flasim për bordin. Ju lutem, të dëgjohemi me vëmendje! Nëse ne dëshirojmë t'i emërojmë anëtarët e Bordit të ART-së, atëherë duhet që këtë ligjin që e kemi aprovuar, ta bëjmë ashtu si duhet, sepse me ligj kemi të drejtë ne që themi duhet të jenë dy dhe e interpretojmë ashtu, se atëherë shko tash në Gjykatën Kushtetuese për të bërë interpretimin e ligjeve, sepse juve na s'po ju besojmë se është mirë. Dhe, tash, deri të shkojmë në Gjykatën Kushtetuese, ky ligj do të mbetet i interpretuar ashtu qysh dëshirojmë ne dhe ashtu qysh dëshironi ju, sepse është mungesë e interpretimit.

Unë po them sinqerisht, kam të drejtë për tu siguruar që mandatet e jo më shumë se 2 anëtarëve të skadojnë brenda një viti kalendarik, mandatet e anëtarëve fillestarë mund të shtyhen dhe unë them që mund të shtyhen dhe duhet të shtyhen dhe ju po thoni që nuk shtyhen. Atëherë, tregoni burrë, unë nuk po mund ta shpjegoj, tregojeni realitetin. Edhe komisionet hetimore, më duket që më herët e përmendi zonja Edita një komision hetimor. Edhe komisionet hetimore ne kemi provuar t'i formojmë, por s'na ka ndez. Për katër deputetë i keni shti brenda 4 minutave të na i tërheqin nënshkrimet dhe më vonë keni thënë se janë tërhequr deputetët. Janë tërhequr deputetët e minoriteteve, sepse ju i keni nën kontroll ata, ne s'mund t'u themi atyre mosni, amani ju qoftë. Ata e kanë qitur nënshkrimin dhe pas një kohe e kanë tërhequr. Ne prapë mund ta bëjmë, dhe ju prapë i thirrni, e keni qeverinë, i keni ato punët tuaja çka ju bëni atyre, qysh i tërhiqni, po ata tërhiqen. Mirëpo, edhe shumë gjëra tjera që shkojnë në Kuvendin e Kosovës, që vijnë këtu nga Qeveria, më vonë edhe nëse procedohen në Kuvend, tërhiqen dhe ne e dimë këtë. Ne kemi raste këtu, unë po i përmendi rastet, nuk po i përmendi fjalët. Para një kohe ka qenë rasti, që kur kemi dashur ta bëjmë një komision hetimor çfarë do qoftë, qoftë për ART-në, qoftë për diçka tjetër, ju i keni thirr ata deputetët e minoriteteve dhe i kanë tërhequr... Dhe, unë kur e kam pyetur një prej deputetëve – çka të bëj zotëri?! Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Zonja Edita, meqë iu përmend emri.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit! Zoti Gani, desha t'ju shpjegoj arsyet pse e kam kërkuar komisionin hetimor. Një arsyeje lidhet pikërisht ...

KRYESUESI: Zoti Buçinca, të lutem një vërejtje ia dhamë Driton Talit për replikë nga vendi. Të njëjtën e ke edhe ti. Janë autoritetet që vlerësojnë punën e drejtimit të seancës qysh po e bëj unë. Vazhdoni, ju lutem!

EDITA TAHIRI: Zoti Gani Geci, desha t'ju jap shpjegime pse e kam kërkuar komisionin hetimor. Janë dy arsye. E para lidhet me temën e sotme dhe vetëm aty po ndalem. Lidhet me përbërjen e re që është votuar dhe aty është Lulzim Kurtaj si kontinuitet, po vetë Lulzim Kurtaj ka shkelur ligjin dhe atë e ka shkelur ligjin me rastin e një pune më të madhe, pra licencimin e IPKO-s, ku si kryetar i Komisionit për vlerësim nuk ka pasur të drejtë të votojë për vendimin dhe kjo është arsyeja.

KRYESUESI: Faleminderit! Është diskutuesi i fundit Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zotëri kryesues!

Kolegë deputetë,

Pasi që jam i fundit, me të vërtetë unë pajtohem me këtë listë. Arsyeja e parë është mosha e re mesatare që janë të propozuar dhe kjo është pse unë do t'i jap përkrahje, si pikë e parë.

(Ndërhyrje)

Femra! Të kishte pasur 30%, kështu kishte pasur edhe femra. Ne po pajtohemi që interpretimin e ligjit jemi deputetë dhe mund ta bëjmë. Unë do ta interpretoj se nuk do të thotë se është patjetër të vazhdohet mandati i 2 anëtarëve. Këtë e vlerëson organi i cili i propozon, në këtë rast Ministria kompetente dhe Qeveria, por kur flitet për njerëzit e propozuar, duhet pasur pak kujdes. Unë vetëm një shembull ose një njeri po e marr, Nijazi Ademaj është autoritet dhe autoritet profesional, i cili ka dhënë kontribut shumë të madh edhe para luftës, edhe gjatë luftës, edhe pas luftës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Duke falënderuar deputetët për kontributin e tyre, po e quajmë kontribut edhe atë që ndoshta s'ka qenë i tillë, procedojmë më tutje me votimin e këtij Propozim-vendimi të Qeverisë për zgjedhjen e Bordit të ART-së.

Kërkoj nga regjia që të konstatojë gjendjen e deputetëve, gjendjen numerike të deputetëve prezent. Do të thotë, 68 deputetë, me zotin Tali që sa po hyri, janë në sallë. Lus deputetët që të përgatiten për votim, me ngritje dore, natyrisht për shkak të rrethanave, por që ta mbajnë pak më gjatë dorën lartë ata që janë “për” deri sa t'i numërojnë regjia.

Kush është “për”? Regjia le t'i numërojë saktë votat. Faleminderit!

Kush është “kundër”?

Kush abstenon? Faleminderit!

Nga 68 deputetëve prezentë, 32 kanë votuar “për”, 28 “kundër” dhe të tjerët kanë abstenuar, që do të thotë se me shumicën e deputetëve prezentë miratohet Propozim-vendimi i komisionit parlamentar për zgjedhjen e Bordit të ART-së.

Faleminderit! Me kaq përfundoi seanca.

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale